



Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve

Botimi i pestë

Qershor 2021



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve

Botimi i pestë

Qershor 2021

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje ekzekutive	6
Hyrje	7
Pjesa e parë: Dialogu ndërmjet komuniteteve, pajtimi, siguria dhe zbatimi i ligjit;.....	9
Pjesa e dytë: Mekanizmat e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve;	17
Pjesa e tretë: Përdorimi i gjuhëve.....	22
Pjesa e katërt: Qasja në drejtësi, performanca e sektorit të drejtësisë dhe përfaqësimi i komuniteteve në sektorin e drejtësisë	26
Pjesa e pestë: Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut (Institucioni i Avokatit të Popullit).....	29
Pjesa gjashtë: Trashëgimia fetare dhe kulturore.....	33
Pjesa e shtatë: Mediat në gjuhët e komuniteteve joshumicë.....	36
Pjesa tetë: Kthimi dhe të drejtat pronësore të personave të zhvendosur.....	39
Pjesa nëntë: Arsimi.....	44
Pjesa dhjetë: Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian	48
Pjesa njëmbëdhjetë: Integrimi socio-ekonomik	52
Konkluzion.....	56

Lista e shkurtesave

MATP	Masat aktive të tregut të punës
KK	Komiteti për Komunitete
KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
RVDK	Raporti për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve
KDIK	Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim i Kuvendit të Kosovës
ZKKKK	Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete
NKKK	Nënkryetari i Komunës për Komunitete
EQUINET	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë
KKPK	Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
VSHSH	vizita “shko-dhe-shih”
DÇPB	Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
KZM	Këshilli për Zbatim dhe Monitorim
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
GPNM	Grupi Punues Ndërministror
IPA	Instrument i BE-së për ndihmën e para-anëtarësimin
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
RRKAP	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KFOR	Forca në Kosovë
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
PLV	Plani lokal i veprimit
LSHC	Ligji për shërbimin civil
LMPDIKP	Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve e pjesëtarëve të tyre
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
KKV	Komiteti Komunal për Veprim
KKK	Komisioni Komunal për Kthim
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MASHZHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit të Teknologjisë
MPB	ish Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	ish Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
ZKKK	Zyrat komunale për komunitete dhe kthim
GPKK	Grupi punues komunal për kthim
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë

IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë
ZQSKeM	Zyra e Qeverisë së Serbisë për Kosovë dhe Metohi
ZKGJ	Zyra e Komisionarit për Gjuhë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RROGRAEK	Rrjeti i Organizatave të Grave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
RTK	Radio dhe Televizioni i Kosovës
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
ZMV	Zonë nën mbrojtje të veçantë
KVP	Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit
UMV	Universiteti i Mitrovicës Veriore
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
VoRAE	OJQ "Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve"
YIHR	OJQ "Iniciativa Rinore për të Drejta të Njeriut"

Hyrje

Zbatimi i Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës (KiE) për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK) në Kosovë monitorohet që nga viti 2004. Raporti i parë i progresit i është dorëzuar Komisionit Këshillëdhënës për KKPK në qershor të vitit 2005. Komisioni Këshillëdhënës ka miratuar Opinionin e parë për Kosovën¹ në nëntor të vitit 2005, të pasuar nga Rezoluta e parë për Kosovën e Komitetit të Ministrave² në qershor 2006. Janë zhvilluar katër cikle monitorimi. Që nga ajo kohë, Rezoluta e fundit për Kosovën është nxjerrë në korrik të vitit 2019.

Çdo cikël i monitorimit fillon me dorëzimin e raportit të progresit në Komisionin Këshillëdhënës për KKPK, i cili më pas nxjerr një opinion, që pasohet nga komentet e palës së monitoruar. Më pas, Komiteti i Ministrave i KiE nxjerr rezolutë me rekomandime për përmirësimin që duhet ta bëhet në zbatimin e KKPK-së. Ciklet përmbillen me një vizitë pasuese për dialogim me palën e monitoruar.

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) boton në mënyrë periodike raporte mbi vlerësimin e të drejtave të komuniteteve (RVDK) për ta matur përparimin që institucionet në Kosovë kanë shënuar me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ministrave të KiE. Botimet të tanishëm i kanë paraprirë katër RVDK tjera, përkatësisht në vitet 2009³, 2010⁴, 2012⁵ dhe 2015⁶. Këto RVDK janë përdorur si raporte progresi për monitorimin e KKPK-së në Kosovë.

Botimi aktual i pestë i RVDK pasqyron vlerësim të situatës nga dhjetori i vitit 2019 për secilën fushë të monitorimit të përcaktuar me Opinionin e fundit të Komisionit Këshillëdhënës për KKPK (mars 2017)⁷ dhe rekomandimet e Rezolutës pasuese (korrik 2019)⁸. Zhvillimet domethënëse që nga përfundimi i periudhës së raportimit në korrik 2015 për RVDK-në e katërt janë të përfshira në këtë botim. Gjetjet e paraqitura në këtë raport janë mbledhur nëpërmjet monitorimit të rregullt të OSBE-së mbi pajtueshmërinë

¹ Komisioni Këshillëdhënës i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, *Opinion i parë për zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë*, 2 mars 2006 <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchService/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008c06b> (qasur më 15 maj 2020).

² Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, *Rezoluta ResCMN(2006)9 për zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë*, 21 qershor 2006 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805d7dec (qasur më 15 maj 2020).

³ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve*, dhjetor 2009, gjendet tek: <https://www.osce.org/kosovo/40779?download=true> (qasur më 15 maj 2020).

⁴ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve – Botimi i dytë*, dhjetor 2010, gjendet tek: <https://www.osce.org/kosovo/74597?download=true> (qasur më 15 maj 2020).

⁵ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve – Botimi i tretë*, korrik 2012, gjendet tek: <https://www.osce.org/kosovo/92244?download=true> (qasur më 15 maj 2020).

⁶ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve – Botimi i katërt*, nëntor 2015, gjendet tek: <https://www.osce.org/kosovo/209956?download=true> (qasur më 15 maj 2020).

⁷ Komisioni Këshillëdhënës i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, *Opinion i katërt për Kosovën*, 8 Mars 2017, gjendet tek: <https://rm.coe.int/fourth-opinion-on-kosovo-adopted-on-8-march-2017/1680779af8> (qasur më 15 maj 2020).

⁸ Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, *Rezoluta ResCMN(2019)11 për zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kosovë*, 3 korrik 2019, gjendet tek: https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectId=090000168095da70 (qasur më 15 maj 2020).

institucionale me legjislacionin për mbrojtjen e komuniteteve dhe gjendjen e komuniteteve në të gjitha komunat në Kosovë. Në kuadër të procesit të mbledhjes së të dhënave për këtë raport është realizuar edhe një hulumtim plotësues i raporteve përkatëse të hisedarëve ndërkombëtarë, organizatave të shoqërisë civile e institucioneve qeveritare që janë nxjerrë gjatë periudhës së raportimit. Të dhënat e mbledhura janë sasiore dhe cilësore për nga natyra, ndërsa për paraqitjen e gjendjes së komuniteteve në Kosovë dhe punën e institucioneve për mbrojtjen, promovimin dhe realizimin e këtyre të drejtave janë përdorur statistika themelore përshkruese.

Ky raport mëton të vlerësojë situatën në fushat përkatëse tematike përballë rekomandimeve që rrjedhin nga Rezoluta e KiE, në formën e një analize të situatës. Raporti nuk del me rekomandime tjera shtesë për institucionet e Kosovës.

Fushat tematike të vlerësimit në raport reflektojnë rekomandimet e Rezolutës së fundit të Komitetit të Ministrave të KiE. Në raport analizohen fushat tematike në vijim:

- 1) Dialogu ndërmjet komuniteteve, pajtimi, siguria dhe zbatimi i ligjit;
- 2) Mekanizmat e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve;
- 3) Përdorimi i gjuhëve;
- 4) Qasja në drejtësi, performanca e sektorit të drejtësisë, përfaqësimi i komuniteteve në sektorin e drejtësisë;
- 5) Institucionet për të drejtat e njeriut (d.m.th. Institucioni i Avokatit të Popullit);
- 6) Trashëgimia fetare dhe kulturore;
- 7) Mediat në gjuhët e komuniteteve joshumicë;
- 8) Kthimi dhe të drejtat pronësore të personave të zhvendosur;
- 9) Arsimitimi i komuniteteve në gjuhët zyrtare dhe ato të komuniteteve;
- 10) Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë;
- 11) Të drejtat socioekonomike të komuniteteve të cenueshme.

KKPK-ja zbatohet drejtpërsëdrejti në Kosovë, ku legjislacioni për të drejtat e komuniteteve bazohet në dispozitat e KKPK.⁹ Ligjet me rëndësi për të drejtat e komuniteteve përfshijnë:

- Ligjin nr. 02/L-037 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006;
- Ligjin nr. 03/L-047 për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë, 13 mars 2008;
- Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 20 shkurt 2008;
- Ligjin nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Kosovës, 21 maj 2008;
- Ligjin nr. 03/L-039 për zonat e veçanta të mbrojtura, 20 shkurt 2008;

⁹ Neni 22 i Kushtetutës erënditë KKPK-në si një nga instrumentet ndërkombëtarë të drejtave të njeriut që është drejtpërsëdrejti e zbatueshme në Kosovë.

Pjesa e parë: Dialogu ndërmjet komuniteteve, pajtimi, siguria dhe zbatimi i ligjit

Rekomandime nga Rezoluta e KiE:

"Tu jepet prioritet përpjekjeve gjithëpërfshirëse dhe konkrete për të promovuar dialogun dhe tolerancën ndëretnike në nivel qendror dhe lokal në mënyrë që të kapërcehen ndasitë ndërmjet komuniteteve dhe të promovohet pajtimi duke pasur parasysh që shumica shqiptare e Kosovës ka një përgjegjësi të veçantë në këtë drejtim; të ndërtohen raporte ndërmjet komuniteteve përmes nismave që synojnë në veçanti të rinjtë, duke integruar sistemin arsimor dhe duke zbatuar në mënyrë të vazhdueshme legjislacionin mbi gjuhët.

Të dënohen të gjitha sulmet e motivuara etnikisht dhe të sigurohet që këto akte të hetohen në mënyrë efektive dhe që kryerësit të ndiqen e sanksionohen, përfshirë përmes përmirësimit të performancës së institucioneve ligjzbatuese në procedimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të mundshme të urrejtjes përmes zbatimit të kornizës ekzistuese ligjore, trajnimeve dhe mbledhjes së të dhënave të besueshme; të vazhdohet me dënimin e të gjitha manifestimeve të diskursit armiqësor në baza etnike."

Nismat për të vërtetën dhe pajtimin

Raportet ndëretnike janë përmirësuar që nga periudha e fundit e raportimit. Ndonëse vazhdon të ketë akoma ndasi të konsiderueshme mes komunitetit shqiptar dhe atij serb, ndërveprimi shoqëror dhe institucional është përmirësuar dhe nuk ka ndodhur asnjë rast dhune e madhe ose kolektive ose ndëretnike. Raportet ndërmjet komunitetit shumicë shqiptar dhe komuniteteve të tjera joshumicë vazhdojnë të jenë funksionale dhe pozitive. Prej formimit të tij në qershor 2012 e deri në mbarimin e mandatit në qershor 2017, Grupi punues ndërministror i Kosovës (GPNM) për ballafaqimin me të kaluarën nuk arriti dot t'i përmbush qëllimet, sidomos për sa i përket përpilimit të një strategjie për drejtësi tranzicionale. Ndër problemet që çuan në dështimin e tij ishin "mangësitë në lidhje me udhëheqjen dhe menaxhimin, pronësinë politike, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve [joshumicë] dhe angazhimin e publikut."¹⁰ Konsulentët të cilët e vlerësuan punën e GPNM-së arritën në përfundimin se, për të qenë të suksesshme, nismat për të vërtetën dhe pajtimin në të ardhmen duhet të marrin mbështetje të mjaftueshme politike dhe t'i përfshijnë në mënyrë efektive të gjithë hisedarët përkatës, përfshirë komunitetet joshumicë.¹¹

¹⁰ Nora Ahmetaj dhe Thomas Unger, *Kosovo's Framework for Dealing With the Past at a Turning Point* [Korniza e Kosovës për ballafaqimin me të kaluarën në një pikë kthese]: *Civil Society Review of Progress Towards a Strategy on Transitional Justice* [Shqyrtim nga ana e shoqërisë civile i përparimit drejt një strategjie për drejtësi tranzicionale], prill 2017, gjendet tek: <http://kosovomemory.org/wp-content/uploads/2018/10/Civil-society-review-of-progress-toward-a-National-Strategy-on-Transitional-Justice.pdf> (qasur më 15 qershor 2020).

¹¹ Po aty.

Janë ndërmarr hapa politik dhe simbolik për të avancuar më tutje iniciativat e së vërtetës dhe pajtimit në rajon. Në vitin 2016, Zyra e Presidentit ua dërgoi katër letra akterëve të gjyqësorit ku u kërkonte që të zbardhin krimet e kryera gjatë konfliktit të Kosovës 1998-1999 dhe në periudhën pas konfliktit.¹² Në mesin e krimeve të specifikuar ishin përfshirë edhe ato të kryera kundër serbëve të Kosovës dhe pronave të tyre. Më 3 nëntor 2016, familjarët e personave të pagjetur serbë u ftuan në Zyrën e Presidentit për të diskutuar mënyrat për sqarimin e fatit të tyre si "parakusht për drejtësi dhe pajtim të sinqertë midis njerëzve."¹³ Familjarët ranë dakord se çështja e të pagjeturve duhet të ishte një nga temat e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel.¹⁴ Më 15 gusht 2016, presidenti vuri kurora në pllakën përkujtimore në Gorazhdec të Komunës së Pejës, të ngritur në përkujtim të vrasjes së dy adoleshentëve serbë në vitin 2003, dhe më 20 korrik 2016 në fshatin Grackë e Vjetër ku 14 serbë ishin ekzekutuan pas konfliktit.¹⁵

Në fund të vitit 2016 dhe fillim të vitit 2017, OSBE mori pjesë në disa takime përgatitore për krijimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit. Procesi ka mbështetjen e gjithë akterëve përkatës, përfshirë shoqërisë civile, ku vlen të theksohet se shoqatat kryesore për personat e pagjetur të cilat përfaqësojnë si shqiptarët ashtu edhe serbë kanë shprehur mbështetjen e tyre dhe po marrin pjesë në mënyrë aktive në këtë proces.

Në mes të vitit 2017, u themelua ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit (KVP) në përbërje kryesisht të akterëve të shoqërisë civile.¹⁶ Nisma ka paraparë punë përgatitore që do të krijonte bazën për KVP. OSBE ka qenë mbështetëse e fuqishme e nismës që nga fillimi, derisa procesi i pajtimit është i mishëruar thellë në mandatin e OSBE-së. Për më tepër puna e OSBE-së udhëhiqet nga rëndësia e sjelljes së respektit të ndërsjellë dhe pajtimit midis të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Në vitin 2019, OSBE mbështeti 15 konsultime publike me hisedarët kryesorë në procesin e pajtimit: shoqatat e familjarëve të të vrarëve dhe të zhdukurve gjatë konfliktit, aktivistë të të drejtave të njeriut, organizatat e grave, organizatat studentore e rinore, gazetarët, profesionistë ligjorë, artistët, historianët, veteranët, të burgosurit politikë, ku që të gjithë përfaqësonin komunitete të ndryshme të Kosovës.¹⁷ Konsultimet publike rezultuan me Projektaktin normativ për themelimin e KVP¹⁸, ndërsa ekipi përgatitor është aktualisht në

¹² Shih tek: <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,4606#.WAW59tV96JA>.

¹³ Balkan Insight, *Kosovo to Take Missing Persons Issue to Brussels* [Kosova do ta çojë në Bruksel çështjen e personave të zhdukur], 4 nëntor 2016, gjendet tek: <https://balkaninsight.com/2016/11/04/kosovo-president-meets-families-of-serb-missing-11-04-2016/> (qasur më 15 qershor 2020).

¹⁴ Shih tek: <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,4627#.WCBS5NL2aJA>.

¹⁵ Balkan Insight, *Kosovo President Lays Wreath at Serbs' Memorial* [Presidenti i Kosovës vendos lule në memorialin e serbëve], 21 korrik 2016, gjendet tek: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-president-lays-wreath-at-serbs-memorial-07-21-2016> (qasur më 15 qershor 2020).

¹⁶ Shih në shqip tek: https://president-ksgov.net/repository/docs/2019_10_16_125739_VENDIM_PER_EMERIMIN_E_EKIPIT_15102019.pdf

¹⁷ Gjithsej 327 pjesëmarrës dhe pesë takime me përfaqësues të bashkësive fetare (26 pjesëmarrës) që nga shkurti i vitit 2019.

¹⁸ Shih tek: https://president-ksgov.net/repository/docs/2020_02_13_154715_Projekt_Akti_Normativ_shq_shkurt_2020.pdf

finalizim e sipër të fushatës së informimit/ndërgjegjësimit publik. OSBE gjithashtu do të vazhdojë të ofroj mbështetje për ekipin përgatitor.

Tensionet ndërmjet komuniteteve

Tensionet ndërmjet komuniteteve për sa i përket kthimit të personave të zhvendosur mbeten problematikë e vazhdueshme që rishfaqet akoma. Komunitetet pritëse nëpër lokalitete të ndryshme vazhdojnë së treguari rezistencë ndaj kthimit ose integritit të personave të zhvendosur. Për shembull, në vendin e kthimit në Mushtisht të Komunës së Suharekës kanë ndodhur disa incidente, përfshirë këtu protesta dhe vendosje e pankartave antiserbe¹⁹. Më 28 gusht 2015, në rrënojat e manastirit ortodoks serb të Trinisë së Shenjtë që ndodhet në këtë fshat u gjet një pajisje shpërthyes, ndërsa rreth 500 shqiptarë e bllokuan rrugën për t'ua ndaluar pelegrinëve serbë (përfshirë të kthyer potencialë) vizitën në manastirin e shkatërruar. Bllokadë e ngjashme u bë dhe më 28 gusht 2016. Në prill të vitit 2017, rreth 300 shqiptarë protestuan në fshatin Lubozhdë të Komunës së Istogut kundër kthimit të 13 serbëve.²⁰

Komunitetet pranuese u rezistuan pelegrinazheve dhe vizitave në varreza nga ana e personave të zhvendosur edhe në disa komuna tjera.²¹

Në disa raste ka pasur pretendime për krime luftime. Në Uçë të Komunës së Istogut, një banor shqiptar verbalisht ngacmoi një person të zhvendosur duke e akuzuar se kishte kryer krime luftime gjatë konfliktit të vitit 1999. Ngjashëm, në Reçak të Komunës së Shtimes, këshilli i fshatit i adresoi zyrës komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) një letër proteste me pretendime për krime luftime kundër kthimit të së vetmes familje serbe që kishte parashtruar kërkesë për t'u kthyer.²² Në shkurt të vitit 2016, prokuroria ngriti aktakuzë për krime luftime kundër 14 serbëve nga Klina, ca syresh të kthyer potencialë në

¹⁹ Më 21 gusht 2016, u vendos një pankartë me shkrimin "Kjo është ajo çka lanë pas vetes kur u larguan nga Mushtishti serbët lokalë" në gjuhën shqipe dhe angleze. Në të kishte edhe fotografi të mizorive e shkatërrimeve gjatë konfliktit.

²⁰ Protestuesit ishin të pakënaqur sidomos me kthimin e një ish-komandanti të policisë serbe, për të cilin pohonin të kishte qenë i përfshirë në krime luftime gjatë konfliktit të vitit 1999. Këshilltari për çështje të lidhura me serbët i kryetarit të Komunës së Istogut nxori një deklaratë ku thuhej se gjithë të kthyerit i kishin kaluar verifikimet e së kaluarës nga institucionet e Prishtinës dhe Beogradit dhe se asnjë syresh nuk kishte aktakuzë dhe nuk ishte përballur me gjyq për krime luftime.

²¹ Më 28 gusht 2017, një i kthyer potencial serb, njëherësh anëtar i grupit të punës për kthimin në Mushtisht, me rastin e një vizite pelegrinazhi u arrestua nën akuzën se kishte kryer krime luftime. I njëjti u lirua nga të gjitha akuzat pasi kaloi pesë muaj në burg. Në janar të vitit 2015, afro 100 persona, në mesin e të cilëve kishte banorë e aktivistëve të lëvizjes Vetëvendosje, protestuan kundër vizitës së pelegrinëve serbë në Gjakovë. Rreth 30 shqiptarë u përpoqën të thyenin kordonin e Policisë së Kosovës (PK) që ishte vendosur për ta siguruar vizitën në kishën ortodokse të atyshme. Një nga protestuesit u arrestua dhe dy zyrtarë policorë u plagosën. Protestuesit u shpërndanë pa i ndërprerë pelegrinët. Më 5 janar 2018, një grup serbësh nga Gjakova që ishin zhvendosur në Serbi anuluan vizitën në Gjakovë me rastin e Krishtlindjes Ortodokse të planifikuar për 6 janar për shkak të shqetësimeve të lidhura me sigurinë dhe pretendimeve për kërcënime të publikuara në rrjetet sociale. Më 28 maj 2018, një grup në përbërje të 50-60 shqiptarëve të Kosovës ishte mbledhur në rrënojat e kishës ortodokse serbe "Trinia e Shenjtë" në fshatin Poterq i Ultë të Klinës për të protestuar kundër vizitës së pelegrinëve dhe për ta ndalë atë. Më 21 tetor 2018, u gjuajtën gurë drejt dy autobusëve me pelegrinë, në mesin e të cilëve kishte edhe serbë të zhvendosur, që ishin nisur për tek rrënojat e kishës ortodokse serbe Virgjëresha e Shenjtë e Hvosnos në fshatin Studenicë të Komunës së Istogut.

²² Në letër pretendohet se një anëtar i familjes kishte qenë i përfshirë në një masakër në Reçak të Shtimes në vitin 1999.

fshatrat e kësaj komune.²³ Ka pasur gjithashtu arrestime të tre të kthyerve potencialë nga Prizreni dhe dy tjerëve nga Klina mbi baza të pretendimeve për krime lufte.²⁴

Trendet e sigurisë

OSBE monitoron dhe regjistron incidentet që prekin sigurinë e komuniteteve në Kosovë.²⁵ Në periudhën prej korrikut 2015 deri në dhjetor 2019, OSBE ka regjistruar 1,621 incidente të sigurisë që kanë ndikuar potencialisht në perceptimin e sigurisë së komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal.²⁶ Këtu përfshiheshin incidente që për shënjestër kishin objektet fetare e varrezat, si edhe trashëgiminë kulturore të komuniteteve në pakicë numerike në një komunë të caktuar.²⁷ Sipas statistikave të PK (Policia e Kosovës), në vitin 2016 janë regjistruar tetë raste të këtilla, 17 në vitin 2017, dhjetë në vitin 2018 dhe 12 në vitin 2019.

20.70 për qind të incidenteve të sigurisë që i ka regjistruar OSBE kanë prekur kryesisht vendet e kthimit dhe të kthyerit serbë.²⁸ Shumica sosh kanë qenë plaçkitje të shtëpive të pabanuara të serbëve, vjedhje të vogla të përsëritura të pasurisë së luajtshme të të kthyerve,²⁹ dëmtime prone ose prerje e kundërligjshme e druve nëpër pyje në pronësi të

²³ Aktakuza ishte ngritur nga Gjykata Themelore në bashkëpunim me Departamentin për Krime Lufte në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Për të akuzuarit u lëshuan fletëarreste që iu shpërndanë të gjitha stacioneve policore në Kosovë, gjitha pikëkalimeve kufitare dhe në aeroport.

²⁴ Dy të kthyer, ndër të cilët një grua, u liruan, derisa një tjetër është ende në paraburgim.

²⁵ OSBE monitoron dhe regjistron incidente që konsiderohen të ndikojnë potencialisht te komunitetet në pakicë numerike në nivel komune, përfshirë këtu komunitetin shqiptar të Kosovës në komunat ku këta të fundit nuk përbëjnë shumicën. Informatat mblidhen prej burimeve të ndryshme, siç janë raportet e Policisë së Kosovës, intervistat e personelit të OSBE-së me pjesëtarë të komuniteteve dhe me zyrtarë komunalë, raporte të organizatave tjera ndërkombëtare, si dhe raportimet e mediave.

²⁶ Të gjitha llojet e incidenteve ku viktimat është pjesëtarë e një komuniteti në pakicë numerike në komunën e caktuar.

²⁷ Në vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018 janë shkruar mbishkrime anti-serbe në muret e kishës ortodokse serbe (KOS) të manastirit të Virgjëreshës së Shenjtë në Gjakovë. Mbishkrime janë shkruar dhe në muret e oborrit të KOS së Paraqitjes së Virgjëreshës së Shenjtë në Lipjan, KOS të Shën Pjetrit në fshatin Brod të Komunës së Shtërpçës, në muret e varrezave ortodokse serbe në Prizren dhe në KOS të Shën Nikollës në Prishtinë. Gjatë periudhës së raportimit, pesë vjedhje kanë ndodhur në Manastirin e KOS Shën Nikollë Mrekullibërësit në Goriq të Komunës së Istogut, dhe tri tjera në Manastirin e KOS Shën Kozma dhe Damjanit në Zoqisht të Komunës së Rahovecit. Në vitin 2019, kanë ndodhur tri raste të vjedhjeve me thyerje në Kaçanik dhe vjedhje në Sërbicë të Ulët të Komunës së Prizrenit dhe në fshatin Banjskë në Vushtrri. Katër raste të goditjes me gurë: të shtëpisë së famullisë në Vushtrri; të shtëpisë së famullisë në Rahovec; të KOS të Shën Pjetrit dhe Palit në Talinoc të Komunës së Ferizajt. KOS e Trinisë së Shenjtë në fshatin Bablak në komunën e Ferizajt është goditur me gurë për të 17-tën herë në dhjetë vitet e fundit. Dëmtim i gurëve të varreve është raportuar në Videjë dhe në Deiq të Komunës së Klinës, si edhe në Brestovik të Komunës së Pejës. Në vitin 2019 janë raportuar dëmtime të gurëve të varreve në Berivojcë të Komunës së Kamenicës, në Dush të Klinës dhe në Ferizaj. Varreza në Lipjan është përdhosur dy herë dhe në secilin rast janë dëmtuar ose shkatërruar rreth 20 gurë varresh. Është raportuar ngacmim verbal i murgjve të manastirit të Dragancës dhe i një prifti në Stanishor të Komunës së Novobërdës. Në vitin 2019 është raportuar për prerje të kundërligjshme të druve në manastirin e Dragancës dhe për shkatërrimin për të pestën herë e një shenje që tregon rrugën për në manastir.

²⁸ Kjo përkthehet në gjithsej 337 raste, ku përfshihen dëmtime të dyerve e dritareve si dhe vjedhje të pajisjeve shtëpiake, orendive dhe furnizimeve me ushqime. Në disa raste, është raportuar për shkatërrimin e puseve, rrethojave të oborreve dhe të objekteve të tjera në afërsi të shtëpive. Në vitin 2019, në qytetin e Klinës janë raportuar raste të hedhjes së gurëve dhe të vënies në zjarr të pronave të të kthyerve. Në shumë raste, shënjestër e vjedhjeve janë gra të moshuara serbe të cilat jetojnë vetëm dhe zakonisht janë serbët e vetëm në fshat. Një rast i pengimit të lirisë së lëvizjes u raportua kur një gruaje serbe iu pengua qasja në pjesën e saj të një pylli.

²⁹ Për shembull, një grua e moshuar serbe që është kthyer në fshatin Pjetërq i Poshtëm të Komunës së Klinës është shënjestruar gjashtë herë gjatë periudhës së raportimit. Asaj iu vodhën gjithsej 26 pula dhe, madje, gjatë një sulmi gruaja pësoi pak lëndime derisa po përpiqej ta mbronte pronën e saj.

të kthyerve.³⁰ Incidentet kanë ndodhur më së shpeshti nëpër vende ku është shënuar shkallë më e lartë e kthimit, sikurse në komunat e Pejës, Istogut e Klinës. Një nga incidentet më të rënda gjatë kësaj periudhe të raportimit ishte një sulm verbal ndaj tetë të moshuarve të zhvendosur gjatë një vizite "shko-dhe-shih" (VSHSH) në Deçan në dhjetor të vitit 2016. PK-së iu desh që t'i evakuonte personat e zhvendosur.³¹ Gjithashtu, në korrik të vitit 2016, një serb i kthyer në moshë të shtyrë u sulmua nga një shqiptar në një dyqan berberi.³²

Reagimet e institucioneve

Gjatë periudhës së raportimit, PK ka vazhduar t'u përgjigjet në mënyrë proaktive incidenteve që prekin komunitetet si në kuptimin e hetimeve ashtu edhe informimit. Gjithashtu, PK është përgatitur për vizitat e pelegrinëve ortodoksë serbë duke përpiluar plane operacionale, duke ofruar përcjellje sa herë që i është kërkuar dhe duke i shtuar patrullimet në zonat përkatëse. Për më tepër, PK ka marrë pjesë aktive në forumet e sigurisë, të tilla si këshillat komunalë për siguri në bashkësi³³ (KKS) dhe komitetet lokale të sigurisë publike³⁴ (KLSP), dhe ka adresuar shqetësimet përkatëse të lidhura me sigurinë.

Komunat duhet të sigurojnë kushte për kthim të qëndrueshëm dhe stabilizim të komunitetit.³⁵ Në disa raste, komunat kanë bërë hapa pozitivë dhe kanë shënuar përparim domethënës në adresimin e kundërshtimeve ndaj kthimit. Për shembull, në mars të vitit 2016, Komuna e Klinës organizoi një ngjarje sportive për ta promovuar mesazhin e bashkëjetesës paqësore midis komuniteteve.³⁶ Në raste të tjera, komunat i kanë kompensuar viktimat e incidenteve të sigurisë.³⁷ Në disa raste, zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) është angazhuar krahas kryetarëve dhe nënkryetarëve të komunave në nismat për ngritje të besimit dhe ka lehtësuar ndërmjetësimin ndërmjet komuniteteve pritëse dhe të kthyerve, siç është rasti me fshatin Lubozhdë në Komunën e Istogut.

³⁰ Raportimet kanë pasur zakonisht të bëjnë me zonat përreth fshatrave Lëvoshë dhe Brestovik në Komunën e Pejës, dhe fshatrat Tuqep, Kosh e Osojan në Komunën e Istogut. Në tetor të vitit 2016, një i kthyer i moshuar u sulmua fizikisht në Osojan derisa po mbronte pyllin e tij nga prerjet e paligjshme.

³¹ Zyrtari komunal i kishte akuzuar personat e zhvendosur për përfshirje në krime të luftës dhe kishte kërcënuar me pamundësimin e kthimit të tyre deri sa të mos zbulonin vendndodhjen e shqiptarëve të zhdukur.

³² Përkundër dëshmisë së viktimës para gjykatës se gjatë sulmit kryerësi kishte bërë deklaratë për çmues etnike kundër tij dhe komunitetit serb të Kosovës, kryerësi u akuzua për "prishje të rendit dhe qetësisë publike".

³³ KKS-të janë themeluar nëpër komuna për ta institucionalizuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve komunale, komuniteteve dhe policisë.

³⁴ KLSP-të ekzistojnë në një numër zonash më të vogla brenda komunave, siç janë fshatrat e largëta dhe shumëetnike, ku është në interes të policimit efektiv dhe marrëdhënieve të mira me të gjitha komunitetet që të ketë forume të këtilla. KLSP-të përbëhen nga përfaqësues të komunitetit lokal të cilët i zgjedh vet komuniteti. Policia e Kosovës konsultohet me këto komitete për çështje të rendit dhe sigurisë në zonat ku këto të fundit veprojnë.

³⁵ Neni 1.1, Rregullorja 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim, 12 gusht 2010.

³⁶ Më 12 mars 2016 u mbajt një turnir futbollit me moton "Ta ndërtojmë të ardhmen së bashku" me pjesëmarrje të administratës komunale të Klinës, KFOR-it sloven dhe pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës nga komuna.

³⁷ Komuna e Klinës i pagoi 300 Euro një të kthyeri serb të Kosovës si kompensim për 1000 duaj sanë. Komuna e Istogut ka kompensuar financiarisht një familje serbe nga fshati Sinajë në vlerën prej 300 Euro për 1000 dengjet e sanës të cilave u ishte vënë zjarri nga person(a) i panjohur.

Sidoqoftë, reagimet e komunave ndaj kundërshtimit të komuniteteve pritëse ndaj kthimeve përcillen me dallime të mëdha nga njëri rast në tjetrin. Në shumicën e vendeve të ndjeshme të kthimit, komunat nuk kanë bërë fare ndërmjetësim në mbështetje të procesit të kthimit. Për më tepër, jo të gjithë bashkëbiseduesit përkatës kanë qenë të angazhuar në nismat e komunave. Për shembull, në grupin punues komunal për kthim (GPKK) shpeshherë nuk kanë qenë të angazhuar zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete (ZKKKK), komiteti për komunitete (KK) dhe KKSB, përkundër faktit që integrimin e komuniteteve e kanë pjesë të mandatit.

Përkundër ca shembujve të nismave pozitive, reagimet e komunave ndaj kundërshtimeve të komuniteteve pritëse ndaj kthimit janë kryesisht në baza *ad hoc*, jo të njëtrajtshme dhe nuk përbëjnë ndonjë përpjekje serioze nga ana e institucioneve të Kosovës për ta adresuar kthimin në mënyrë tërësore. Monitorimi i OSBE-së ka identifikuar vetëm përpjekje të kufizuara të komunave për t'i adresuar tensionet ndërmjet komuniteteve për sa i përket kthimit të personave të zhvendosur dhe për ta ngritur besimin.

Në shumicën e rasteve, të kthyerit raportojnë në PK incidente në vendet e kthimit dhe incidente që prekin objektet fetare. Para vitit 2019, pjesëtarët e komuniteteve thoshin se ndjeheshin të dekurajuar që t'i raportonin incidentet për arsye se përvojat nga rastet e mëhershme kishin treguar që kishte pak gjasa të identifikohesh kryerësi(t). Një gjë e tillë mund të ketë ndikuar në perceptimin e sigurisë të të kthyerit dhe të ketë penguar procesin e kthimit.³⁸ Gjithashtu, në komunat me numrin më të madh të të kthyerve serbë të Kosovës si Istogu, Klina dhe Peja janë caktuar vetëm disa zyrtarë policorë serbë. Mirëpo, në vitin 2019 situata ka ndryshuar dukshëm, pasi që të kthyerit serb kanë theksuar në një numër rastesh se ishin të kënaqur me punën dhe reagimin e shpejtë të PK-së.

Në vitin 2017, nën patronatin e Nëngrupit punues për siguri, dialog dhe riintegrim përgjegjës për zbatimin e Procesit të Shkupit, Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), ish-Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe ish-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) hartuan "Udhëzimet për reagimin e mekanizmave në nivel lokal ndaj incidenteve që prekin komunitetet" (në tekstin e mëtejshëm, Udhëzimet). Në këto Udhëzime përcaktohen hapat që duhen ndjekur nga institucionet komunale (kryesisht kryetarët e komunave, KKSB-të dhe ZKKK-të) për të siguruar reagime efektive dhe të qëndrueshme ndaj çështjeve të sigurisë që prekin komunitetet, përfshirë këtu edhe të kthyerit.³⁹ Udhëzimet u janë shpërndarë kryetarëve të komunave dhe ZKKK-ve më 18 Janar 2018.

Sipas Udhëzimeve, kryetarët e komunave dhe zyrtarë të tjerë të lartë të komunës priren që t'i dënojnë incidentet serioze si zjarrvëniet, të shtënat me armë ose sulmet.⁴⁰ Ministri për Komunitete dhe Kthim lëshon gjithashtu deklarata çdo herë në kohë ku i dënon

³⁸ Sipas monitorimit të rregullt në terren të OSBE-së.

³⁹ MKK, MPB dhe MAPL i hartuan Udhëzimet me mbështetjen e OSBE-së dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR).

⁴⁰ Në vitin 2015 janë bërë gjithsej 25 dënime publike të incidenteve, 23 në vitin 2016, 21 në vitin 2017, 18 në vitin 2018, dhe 33 në vitin 2019.

incidentet e tilla dhe madje në ca raste viziton vendet në fjalë. Në përgjithësi, dënimi i menjëhershëm i incidenteve dhe vizitat në vend të ngjarjes nga zyrtarët e lartë janë vendimtare për adresimin e ndikimit negativ të incidenteve të këtilla në perceptimet e komuniteteve për sigurinë. Megjithatë, monitorimi në terren i OSBE-së tregon se jo të gjitha këto dënime arrijnë deri tek të gjitha komunitetet e prekura ose popullata shumicë në atë zonë. Zakonisht, dënimet e këtilla botohen në faqen e internetit të komunës apo nëpër pano informuese, dhe jo përmes mediave lokale.

Përmes përpjekjeve të saja programatike, OSBE ka mbështetur KKSBB-të që "luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e tolerancës ndërmjet komuniteteve dhe zbatimin e masave për ngritjen e besimit, si dhe për krijimin e një lidhjeje midis komuniteteve dhe institucioneve tjera komunale".⁴¹ Megjithatë, vazhdon të ketë akoma sfida për sa i përket mënyrës se si KKSBB-të e ushtrojnë rolin dhe përgjegjësitë e tyre në adresimin e shqetësimeve të komuniteteve, incidenteve që prekin grupet e cënueshme dhe zbatimin e masave proaktive për parandalim dhe për kontaktim të komuniteteve.

Luftimi i krimit të urrejtjes

Si reagues i parë që është, PK e njej detyrën e vet për të identifikuar, hetuar dhe reaguar në mënyrë adekuate ndaj krimeve të mundshme të urrejtjes. Politika e PK-së për krimet e nxitura nga urrejtja dhe krimet ndëretnike parasheh procedura të hollësishme për hetimin e krimeve të urrejtjes dhe reagimin ndaj tyre,⁴² përfshirë këtu: hapat specifikë që PK duhet t'i ndërmarrë me rastin e reagimit të parë në vendin e ngjarjes, detyrat e mbikëqyrësit dhe të hetuesve, masat për të parandaluar përsëritjen e krimeve të urrejtjes dhe kontaktimin me komunitetet e prekura.

Aktualisht KP-ja përdorë një bazë të dhënash për t'i regjistruar incidentet ndëretnike, porse incidentet e tilla mund ose mund të mos kenë motiv paragjykimi. Baza e të dhënave nuk përmban të dhëna të kategorizuara që do ta bënë të mundshëm identifikimin e krimeve të mundshme të urrejtjes bazuar në karakteristika tjera të mbrojtura përveç etnisë. Megjithatë, në vitin 2018 KP ka ndryshuar raportin fillestar të incidenteve ku përveç kutizës ekzistuese të motivit ndëretnik ka shtuar edhe një kutizë për motivin e krimit të urrejtjes.

Në shkurt të vitit 2018, MPB, PK, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për trajtimin e krimeve të urrejtjes (në tekstin e mëtejme, Marrëveshja) në Kosovë. Marrëveshja parasheh obligime për secilin institucion me qëllim të përmirësimit të regjistrimit të krimeve të urrejtjes. Në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes, në periudhën prej 20 shtatorit deri më 29 tetor 2018, OSBE lehtësoi takimet mes PK-së dhe tetë rrjeteve rajonale në përbërje të hetuesve, zyrtarëve policorë në bashkësi dhe prokurorëve, ku pjesëmarrësit dhanë rekomandime

⁴¹ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Reagimet komunale ndaj incidenteve të sigurisë që prekin komunitetet në Kosovë dhe roli i Këshillave Komunalë për Siguri në Bashkësi*. dhjetor 2011, gjendet në: <https://www.osce.org/kosovo/86766?download=true> (qasur më 15 maj 2020).

⁴² Policia e Kosovës, *Politikat dhe procedurat, Krimet e urrejtjes dhe krimet ndëretnike*, korrik 2002, rishikuar në tetor 2009.

për mbështetjen e rrjeteve rajonale në përmbushjen e detyrës së tyre për të identifikuar dhe regjistruar krimet e urrejtjes.

Kodi i ri penal i Kosovës (KPK) u botua në Gazetën Zyrtare më 14 janar 2019, ndërsa hyri në fuqi tre muaj më pas. OSBE kishte dhënë rekomandim gjatë procesit të hartimit të Kodit se vepra penale e kryer me motiv të paragjykimit duhet të përbëjë vepër penale unike, që tani është pasqyruar në nenin 70 (2) (12) të KPK-së.⁴³ Si rrjedhojë e kësaj dispozite, lëndimet e lehta trupore, lëndimet e rënda trupore, asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë, vrasja dhe sulmi i kryer me motiv të paragjykimit mbi bazat e karakteristikave të mbrojtura të parapara në KPK konsiderohen forma të rënduara të veprës penale. Për vepra të tilla parashihen dënime më të rënda.

Përfaqësimi i komuniteteve në Policinë e Kosovës

Në lidhje me përfaqësimin e komuniteteve joshumicë në radhët e PK-së, statistikat zyrtare që i janë komunikuar OSBE-së tregojnë se në vitin 2019 nga gjithsej 7.959 zyrtarë policorë 12.16 për qind ishin serbë, 2.45 për qind ishin boshnjakë, 0.84 për qind ishin turq, 0.45 për qind ishin goranë, 0.23 për qind ishin ashkali, 0.19 për qind ishin romë, 0.10 për qind ishin egjiptianë, 0.04 për qind ishin kroatë, 0.04 për qind ishin malazezë dhe 0.09 për qind u përkisnin bashkësive që nuk njihen zyrtarisht me kornizën ligjore.

Nxitja e bashkëpunimit ndërkomunal në Kosovë

Që nga viti 2013, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, disa grupe të kryetarëve të komunave kanë nënshkruar deklaratatë të bashkëpunimit ndërkomunal për promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve. Grupi i parë përbëhej nga katër komuna: Gjilani, Kamenica, Novobërda dhe Ranillugu. Deklaratatë të tilla kanë nënshkruar edhe pesë grupe tjera:

- Ferizaj, Klllokoti dhe Shtërpca (maj 2015);
- Fushë Kosova, Graçanica, Lipjani, Obiliqi, Prishtina, Shtimja (prill 2016);
- Dragashi, Malisheva, Mamusha, Prizreni, Suhareka, Rahoveci (qershor 2017);
- Deçani, Gjakova, Istogu, Juniku, Klina, Peja (maj 2018);
- Mitrovica Jugore, Podujeva, Skenderaj, Vushtrria (korrik 2019).

Pas nënshkrimit të deklaratave, komunat kanë zbatuar shumë aktivitete me të rinj të komuniteteve të ndryshme, përfshirë kampe rinore, turne sporti, shkëmbime kulturore ndërfaqetare dhe nisma për mësimin e të dyja gjuhëve zyrtare.

⁴³ Neni 70, paragrafi 2, pika 2.12: “me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese [...] nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale.”

Pjesa e dytë: Mekanizmat e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve

Rekomandime nga Rezoluta e KiE:

"Të bëhen hapa për të siguruar që korniza ligjore ekzistuese në lidhje me pakicat kombëtare të zbatohet në mënyrë korrekte duke forcuar mekanizmat për bashkërendimin, pronësinë dhe monitorimin e strategjive e planeve të veprimit në nivel qendror dhe duke përmirësuar shpërndarjen e përgjegjësi të qeverisë qendrore dhe llogaridhënien e saj, si dhe duke vazhduar me shtimin e kapaciteteve për komunikim në nivel lokal.

Të garantohet përfaqësimi efektiv në Kuvendin e Kosovës i komuniteteve pakicë që janë tradicionalisht të pranishme në territorin e Kosovës, përfshirë komunitetet kroate dhe malazeze, përmes ndarjes së një numri adekuat të ulëseve të rezervuara; të sigurohen mundësi efektive për personat nga radhët e të gjitha komuniteteve pakicë, përfshirë ato numerikisht më të vogla, për të marrë pjesë në proceset përkatëse të vendimmarrjes në nivel qendror dhe lokal duke siguruar që të gjitha përpjekjet të jenë në funksion të integritimit.

Të konsultohet në mënyrë efektive Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) për të gjitha çështjet me rëndësi për komunitetet pakicë dhe të sigurohet që mekanizmat specifikë për mbrojtjen e komuniteteve të përmbushin në mënyrë efektive rolin e tyre si mundësi për të gjithë pakicat që të marrin pjesë në vendimmarrje; të rritet punësimi i personave që u përkasin komuniteteve pakicë në administratën publike; të bëhen përpjekje për të siguruar pranimin e të kthyerve nga komuniteti shumicë."

Strategjitë

Strategjisë së mëparshme për komunitete dhe kthim i ka mbaruar afati në fund të vitit 2018. Deri në fund të vitit 2019, nuk është arritur të hartohet e as miratohet strategjia e re. Përgjegjësia për hartimin, dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali i takon Zyrës për Qeverisjes të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ndërsa Ministria për Komunitete dhe Kthim është përgjegjëse për Strategjinë për komunitete dhe kthim. Roli i mekanizmave tjerë në nivel qeverie për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve në hartimin, dhe monitorimin e dokumenteve strategjike që lidhen me komunitetet joshumicë është i paqartë. Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka propozuar përpilimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve dhe çështje tjera të ndërlidhura, por nuk është vërejtur përparim në lidhje me këtë gjatë periudhës së raportimit.

Kuvendi i Kosovës

Që nga botimi i edicionit të mëparshëm të RVDK nuk është bërë asnjë përpjekje për të përfshirë komunitetin kroat dhe atë malazez në Kuvend. Përfaqësimi i komuniteteve të tjera joshumicë në Kuvendin e Kosovës mbetet i siguar nga 20 vendet e garantuara me Kushtetutë.⁴⁴ Zgjedhjet e fundit parlamentare janë mbajtur më 6 tetor 2019. Lista Serbe i ka fituar që të dhjetë vendet e garantuara për komunitetin serb (tri gra, shtatë burra). Tri vendet e garantuara për komunitetin boshnjak u ndanë midis *Koalicionit Vakat* (një grua,⁴⁵ një burrë) dhe *Partisë së Re Demokratike* (një grua). *Partia Demokratike Turke e Kosovës* i fitoi të dy vendet e garantuara për komunitetin turk (një grua, një burrë). Një burrë nga *Partia e Bashkuar e Goranëve* fitoi vendin e rezervuar për komunitetin goran. Një burrë nga *Partia Rome e Bashkuar e Kosovës* fitoi vendin e rezervuar për komunitetin rom, një burrë nga *Partia e Ashkalinjëve për Integrim* vendin e rezervuar për ashkali dhe një burrë nga *Partia Liberale Egjiptiane* vendin e rezervuar për egjiptianë. Një burrë nga *Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës*, parti kjo egjiptiane e Kosovës, fitoi vendin e katërt të garantuar për kandidatin që përfaqëson një parti rome, ashkali ose egjiptiane me vendin e katërt për nga numri më i madh i votave.⁴⁶ Vlen të ceket që në legjislaturat e mëparshme këtë ulëse tradicionalisht e kanë pasur komuniteti ashkali. Dy burra nga radhët e komunitetit serb dhe një tjetër nga radhët e komunitetit turk janë emëruar si ministra në qeverinë e krijuar së fundmi.⁴⁷

Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Kushtetuta parasheh formimin e një Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (KDIK).⁴⁸ KDIK ka mandatin që të rishikojë projektligjet për të siguar se të drejtat e interesat e komunitetit po adresohen në mënyrë adekuate. Një e treta e anëtarëve të tij vijnë nga radhët e deputetëve serbë të Kuvendit të Kosovës, një e treta nga komuniteti shumicë (shqiptarë të Kosovës), ndërsa pjesa tjetër janë deputetë të Kuvendit që përfaqësojnë komunitetet tjera. Sipas përbërjes së tanishme të Kuvendit, KDIK ka në përbërje 18 deputetë, pra 6 nga secili "grup i komuniteteve". Komunitetin serb të Kosovës e përfaqësojnë pesë burra dhe një grua (kryetarja e Komisionit), derisa komuniteti shqiptar i Kosovës përfaqësohet nga gjashtë burra të partive politike të ndryshme. Gjashtë anëtarët e tjerë janë një boshnjake e Kosovës dhe një turke e Kosovës, si edhe katër burra që përfaqësojnë përkatësisht komunitetet romë, ashkali, egjiptian dhe goran.

⁴⁴ Neni 64.2 i Kushtetutës.

⁴⁵ Gruaja në fjalë, Duda Balje, më pas u largua nga *Koalicija Vakat* për të themeluar një parti të re - Unionin Social Demokratik, dhe më vonë iu bashkua grupit parlamentar të LDK-së.

⁴⁶ Deputeti Elbert Krasniqi iu bashkua grupit parlamentar të *Vetëvendosjes*.

⁴⁸ Neni 78 i Kushtetutës.

Këshilli Konsultativ për Komunitete

Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit vazhdon së qeni hisedar kyç në nivel qeveritar që garanton, të paktën në teori, përfshirjen e perspektivave të komuniteteve në vendimmarrje të nivelit të lartë. Ekzistenca dhe roli i KKK-së garantohet si me Kushtetutë ashtu edhe me Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre.⁴⁹ Një raport i OSBE-së i nxjerrë në vitin 2017 lidhur me punën e KKK-së vë në dukje disa çështje:

- Mosvetëdijesimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë për ekzistimin dhe rolin e KKK-së;
- Barazinë e dobët gjinore;
- Bashkëpunimin e pamjaftueshëm me institucionet tjera qeveritare, veçanërisht me Zyrën e Kryeministrit dhe me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- Ndikimin e kufizuar ngaqë KKK jep komente vetëm për një numër të vogël të projektligjeve e strategjive që i pranon dhe nxjerr vetëm rekomandime të pakta për institucionet.⁵⁰

KKK nuk e ka përmirësuar performancën në ndonjë masë të konsiderueshme që nga vlerësimi i 2017-ës. Deri në dhjetor 2019, në suazat e mandatit të vet për periudhën 2018-2020, Këshilli ka rishikuar 11 projektligje e strategji dhe ka dhënë komente për pesë sosh. Mirëpo, është shënuar zhvillim pozitiv për sa i përket barazisë gjinore të KKK-së. Komuniteti ashkali, ai egjiptian, ai goran dhe ai malazez përfaqësohen secili me nga një grua dhe një burrë, komuniteti turk përfaqësohet nga një grua dhe dy burra, komuniteti boshnjak nga dy gra dhe një burrë, si dhe komuniteti serb nga dy gra dhe tre burra. Vetëm komuniteti rom (që përfaqësohet nga dy burra) dhe komuniteti kroat (që përfaqësohet nga dy gra) nuk i përmbushin kriteret e përfaqësimit gjinor siç përcaktohet me statutin e KKK⁵¹.

Kohëzgjatja e shkurtër e mandatit të anëtarëve të KKK-së⁵² sjell si rrjedhojë ndërrimin e shpeshtë të tyre, ndërsa anëtarëve u nevojitet shpesh t'i zhvillojnë kapacitetet për të qenë në gjendje që ta ushtrojnë në mënyrë efektive mandatin. Përveç përmirësimit të bashkëpunimit me institucionet tjera dhe vizitave informuese që u bëhen komuniteteve joshumicë nëpër komuna, argument tjetër për zgjatjen e mandatit të anëtarëve të KKK-së është që kjo gjë do ta shtonte efektivitetin e këtij Këshilli.

⁴⁹ Neni 60 i Kushtetutës.

⁵⁰ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Performanca dhe ndikimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete*, 2017, gjendet tek: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/362846?download=true> (qasur më 15 maj 2020), f. 17-18.

⁵¹ Neni 24 në lidhje me nenin 34 të Statutit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, dhjetor 2017, gjendet tek:

https://president-ksgov.net/repository/docs/2017_12_26_154720_STATUTE_OF_THE_CONSULTATIVE_COUNCIL_FOR_COMMUNITIES_1.pdf (qasur më 15 maj 2020).

⁵² Dy vjet me mundësinë e rizgjedhjes; neni 12.8 i Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, 13 Mars 2008 (LMPDK).

Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në administratën publike

Një raport i nxjerrë nga OSBE në vitin 2017 ka gjetur se, që nga botimi i mëhershëm i RVDK-së, ka pasur përmirësim të vogël në përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në shërbimin civil në nivel qeveritar.⁵³ Shifrat janë ngritur nga 7.85 për qind sa ishin në janar të vitit 2013 në 9.63 për qind në dhjetor 2015, duke mos arritur për pak të plotësohet kriteri prej dhjetë për qind i paraparë me Ligjin për shërbimin civil.⁵⁴ Në përgjithësi, goranët, romët, ashkallitë dhe egjiptianët janë akoma pak të përfaqësuar. Në nivel të komunave, komunitetet numerikisht më të vogla janë të prirura që të mos jenë të përfaqësuara sa duhet dhe "punonjësit nga radhët e komunitetit rom dhe ashkali kanë më shumë të ngjarë të mbajnë pozita të nivelit më të ulët në krahasim me punonjësit nga radhët e komuniteteve tjera."⁵⁵ Megjithatë, gjatë periudhës së raportimit janë vënë re disa përjashtime. Për shembull, në vitin 2019, kryetari i Kamenicës emëroi një rom si drejtor të financave.

Mekanizmat e pjesëmarrjes së komuniteteve në nivel komunal

Në Kosovë ekzistojnë katër mekanizma të pjesëmarrjes së komuniteteve:

- Komitetet për komunitete (KK)⁵⁶

Që nga publikimi i botimit të 4-t të RVDK dhe pas zgjedhjeve komunale të vitit 2017, janë vërejtur përmirësime në lidhje me përfaqësimin e të gjitha komuniteteve në KK, përfshirë komunitetet numerikisht më të vogla. Një gjë e tillë mund të vërehet në 28 komuna për të cilat ka në dispozicion të dhëna nga regjistrimi i popullsisë dhe ku banojnë komunitete joshumicë. Nga ky numër i komunave, 17 i kanë të themeluara KK-të që në përbërjen e tyre kanë pjesëtarë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në atë komunë.⁵⁷ Përmirësime janë shënuar edhe në përbërjen gjinore të KK-ve, ku gratë tani përbëjnë 41.75 për qind të anëtarësisë së KK-ve, krahasuar me 31.03 për qind në mandatin 2013-2017.⁵⁸

⁵³ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë*, 2017, gjendet tek: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/320496?download=true> (qasur më 15 maj 2020), f.5.

⁵⁴ Neni 11 i Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil, 13 maj 2010 (LSHC).

⁵⁵ Shih fusnotën e mësipërme 53, f.5.

⁵⁶ KK-të janë komitete të përhershme të kuvendit të komunës me mandat për të siguruar respektimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë. Këtë mandat e realizojnë përmes shqyrtimit të politikave e akteve të komunës dhe dhënies së këshillave e rekomandimeve për komunën. Krijimi i KK-ve është i detyrueshëm në të gjitha komunat.

⁵⁷ Monitorimi në terren i OSBE-së.

⁵⁸ Po aty.

- Nënkyetari i Komunës për Komunitete (NKKK)⁵⁹

Deri në dhjetor 2019, 13 komuna kanë pasur të emëruar NKKK-në,⁶⁰ përfshirë në gjashtë nga të shtatë komunat ku ky mekanizëm është i detyrueshëm.⁶¹ Një aspekt pozitiv është se tri pozita të NKKK-së ushtroheshin nga pjesëtarë të komunitetit ashkali,⁶² ndërsa tri tjera nga gratë.⁶³

- Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete (ZKKKK)⁶⁴

Që nga dhjetori i vitit 2019, nëntë komuna kishin një ZKKKK në detyrë, përfshirë gjashtë nga shtatë ku ky mekanizëm është i detyrueshëm.⁶⁵ Leposaviqi, Mitrovica e Veriut dhe Zubin Potoku krijuan pozitën e ZKKKK në mungesë të të dhënave zyrtare të regjistrimit. Në anën tjetër, ndonëse krijimin e pozitës e ka të detyrueshme, Graçanica ende nuk ka e emëruar ZKKKK-në. Të gjithë nga dhjetë ZKKKK-të në detyrë janë burra.

- Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)⁶⁶

Deri në dhjetor 2019, ZKKK-të janë themeluar në 35 komuna. Në Mitrovicë të Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok, zyrat komunale për komunitete të krijuara nën administrimin e UNMIK-ut *de facto* e kryejnë rolin e ZKKK-ve.

Siç është theksuar në botimin e katërt të RVDK, mungesa e një kuadri më të detajuar ligjor mbi funksionimin e tyre dhe që rregullon më mirë marrëdhëniet e tyre me institucionet e tjera komunale vazhdon të jetë pengesë kryesore për funksionimin më të mirë të mekanizmave komunale të pjesëmarrjes së komuniteteve. Aktualisht, mekanizmat përgjithësisht bazohen në disa paragrafë të ligjeve primare dhe udhëzuesit për punën e tyre kryesisht gjenden në dokumente jodetyruese të politikave, siç janë Termat e Referencës ose Udhëzimet. Përkundër kuadrit të mangët ligjor, këta mekanizma kanë treguar se mund të jenë mbrojtës të rëndësishëm të të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë.

⁵⁹ NKKK ka mandat të këshillojë kryetarin e komunës për çështje që lidhen me komunitetet. Kjo pozitë është e detyrueshme në ato komuna ku pjesëtarët e komuniteteve joshumicë përbëjnë më shumë se dhjetë përqind të popullsisë; megjithatë, me vendim të kuvendit të komunës, pozita si e tillë mund të krijohet edhe në ato komuna ku madhësia e komuniteteve joshumicë nuk e kalon këtë prag.

⁶⁰ Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Kamenicë, Kllokot, Lipjan, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Prizren, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan.

⁶¹ Dragash, Fushë Kosovë, Kllokot, Novobërdë, Prizren, Shtërpçë. Graçanica nuk e ka emëruar NKKK-në megjithëse e ka të detyrueshme.

⁶² Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan.

⁶³ Kllokot, Mamushë, Prizren.

⁶⁴ ZKKKK ka mandat të shqyrtimit të ankesave nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë që pretendojnë se aktet apo vendimet e kuvendit komunal kanë shkelur të drejtat e tyre. Në rrethana specifike, ZKKKK mund të referojë vendimin e kontestuar drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese. Kjo pozitë është e detyrueshme në komunat ku komunitetet joshumicë përbëjnë më shumë se dhjetë për qind të popullsisë dhe nuk mund të krijohen ligjërisht në komunat ku popullsia e komuniteteve joshumicë nuk e arrin këtë prag.

⁶⁵ Dragash, Fushë Kosovë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Prizren, Shtërpçë, Zubin Potok.

⁶⁶ ZKKK-të janë zyra komunale me mandat për t'i mbrojtur të drejtat e komuniteteve, për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe për të krijuar kushte për kthim të qëndrueshëm. ZKKK-të duhet të themelohen në të gjitha komunat e Kosovës.

Pjesa e tretë: Përdorimi i gjuhëve

Rekomandime nga Rezoluta e KiE:

“Të prioritizohen përpjekjet gjithëpërfshirëse dhe konkrete për të promovuar dialogun dhe tolerancën ndëretnike në nivel qendror dhe lokal, në mënyrë që të mbyllen ndarjet ndërmjet komuniteteve dhe të promovohet pajtimi, duke marrë parasysh që shumica shqiptare ka përgjegjësi të veçantë në këtë drejtim; të ndërtohen marrëdhënie ndërmjet komuniteteve përmes nismave që në veçanti përfshijnë të rinjtë, integrimin e sistemit arsimor dhe zbatimin e vazhdueshëm të legjislacionit gjuhësor.

Të miratohen të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë, të barabartë dhe adekuat të ligjit për përdorimin e gjuhëve; të adresohen boshllëqet e kapaciteteve të nivelit qendror dhe lokal në njohjen e gjuhës, cilësinë e përkthimeve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve në gjuhët e pakicave, përfshirë në sistemin gjyqësor; të krijohet një mjedis i favorshëm që mundëson mësimin e gjuhëve zyrtare dhe të pakicave;

Të adresohen pabarazitë në qasjen në drejtësi mes shumicës shqiptare dhe pakicave; të harmonizohet përdorimi i gjuhës serbe në procedurat gjyqësore dhe administrative me dispozitat e legjislacionit përkatës që rregullon përdorimin e gjuhëve në proceset që përfshijnë komunitetet joshumicë; të rritet edhe më shumë prania e gjyqtarëve, avokatëve dhe stafit mbështetës joshqiptar.”

Implementimi i përgjithshëm

Shqipja dhe serbishtja njihen si dy gjuhët zyrtare në Kosovë.⁶⁷ Boshnjakishtja, turqishtja dhe gjuha rome mund të njihen si gjuhë zyrtare ose gjuhë në përdorim zyrtar në nivelin komunal.⁶⁸ Ligji për përdorimin e gjuhëve rregullon statusin dhe menaxhimin e gjuhëve, përfshirë në komuna.⁶⁹

Zyra e Komisionerit të Gjuhëve (ZKGJ) është themeluar në vitin 2012 dhe ka mandat mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga të gjitha institucionet nën juridiksionin e ZKGJ-së.⁷⁰ Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave gjuhësore të komuniteteve është pjesë thelbësore e mandatit të ZKGJ. Dy mekanizmat mbështetës të ZKGJ janë Bordi i Politikave Gjuhësore dhe Rrjeti i Politikave Gjuhësore.⁷¹ Komisioneri i Gjuhëve u riemërua për mandatin e tij të dytë gjashtëvjeçar në janar 2019. Strategjia për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, e hartuar nga ZKGJ më 2016 ende nuk është miratuar.

⁶⁷ Shih nenin 5.1 të Kushtetutës.

⁶⁸ Po aty, neni 5,2.

⁶⁹ Ligji nr. 02/L-037 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006.

⁷⁰ Shih nenin 16 të Rregullores së qeverisë nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, 4 prill 2012.

⁷¹ Po aty, neni 5.

Në shtator të vitit 2018, OSBE e ka publikuar raportin "*Legjislacioni dygjuhësor në Kosovë*".⁷² Raporti ka ofruar pasqyrim të procesit aktual të hartimit të legjislacionit dygjuhësor në nivel të qeverisë dhe kuvendit, në mënyrë që të nxjerrë në pah mangësitë procedurale dhe praktike dhe të japë rekomandime për të përmirësuar procesin e përpilimit dhe përkthimit dygjuhësh dhe të forcoj zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Raporti konstatoi se nuk ka lekturim sistematik të projektligjeve apo angazhim të rregullt të juristëve në procesin e finalizimit të versioneve në dy gjuhët zyrtare. Për më tepër, derisa ka disa mekanizma që ekzistojnë e që kërkojnë hartim dhe mbikëqyrje konsistente, në praktikë këta nuk ndiqen, si dhe duhen përforcuar. Për më tepër, përgjegjësitë e qeverisë dhe të Kuvendit duhet të qartësohen dhe zbatohen. Mangësitë në nivel qeveritar janë mungesa e kapaciteteve, resurseve dhe trajnimit të përkthyesve ekzistues, si dhe shpërndarja joefikase e këtyre përkthyesve në qeveri është pengesë madhore në rrugën drejt arritjes së përkthimeve të sakta. Mangësitë në nivel të Kuvendit e rëndojnë edhe më tepër mungesën e përgjegjësive dhe koordinimit të qartë brenda qeverisë. Ekziston mungesë e mekanizmave për lekturë të dokumenteve, kontroll të cilësisë dhe sigurim të cilësisë në nivel të Kuvendit. Raportit i parapriu *Forumi për pajtueshmëri gjuhësore në Kosovë*⁷³ organizuar në nëntor 2017 nga ZKGJ dhe OSBE për të ndërgjegjësuar institucionet mbi rëndësinë e pajtueshmërisë gjuhësore, veçanërisht gjatë procesit legjislativ.

Në raportin e tij të fundit vjetor për pajtueshmërinë gjuhësore në komuna, të botuar më 2019,⁷⁴ ZKGJ vuri në dukje progres shumë të kufizuar ose aspak progres në lidhje me pajtueshmërinë gjuhësore të komunave në krahasim me vitet e kaluara. Kapacitetet e përkthimit/interpretimit në komuna janë ende të dobëta. Sfidat që kanë të bëjnë me mungesën e burimeve njerëzore, pajisjeve dhe financimit vazhdojnë. Zhvillimi i një sistemi të monitorimit që përdoret për mbledhjen e të dhënave për këtë raport u mbështet nga OSBE-ja.

Në maj të vitit 2019, qeveria miratoi *Dokumentin konceptual për reformën e procedurave të përkthimit në kuadër të Qeverisë së Kosovës - drejt një legjislacioni të harmonizuar shumëgjuhësh*. Ky dokument hap rrugën për krijimin e një njësie për përkthim, kontroll gjuhësor dhe harmonizim në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. ZKGJ do të ketë rol vendimtar në krijimin dhe koordinimin e njësisë.

Gjatë periudhës së raportimit, Zyra Ligjore e Kryeministrit ishte duke hartuar projektligjin për akte juridike. Akti është përfshirë në agjendën legjislative të qeverisë 2020. Projektligji

⁷² Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Legjislacioni dygjuhësor në Kosovë*, shtator 2018, në dispozicion në: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/396836?download=true> (qasur më 27 prill 2020).

⁷³ Qëllimi i Forumit ishte të sigurojë një platformë ku pjesëmarrës të nivelit të lartë dhe ekspertë nga shtete dygjuhëshe ose shumëgjuhëshe mund të ndajnë përvojat e tyre dhe të promovojnë pajtueshmërinë gjuhësore. Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicë Kombëtare, ambasadori Lamberto Zannier, iu drejtua Forumit, së bashku me ambasadorin Austriak (në emër të Kryesisë së OSBE-së), kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin e Kosovës, si dhe shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Forumi u organizua në nivel të ekspertëve për të shkëmbyer përvojat në lidhje me dygjuhësinë. Pjesëmarrësit, përfshirë Ambasadorët e Zvicrës, Finlandës dhe Belgjikës, si dhe ndihmëszëvendësministri dhe shefi i shërbimeve legjislative në shërbimet e së drejtës publike dhe legjislative, Justice Canada, ndanë modelet, përvojat dhe pikëpamjet e tyre mbi rëndësinë e pajtueshmërisë gjuhësore në juridiksionet e tyre përkatëse.

⁷⁴ Zyra e Komisionerit të Gjuhëve, *Raporti Vjetor për Pajtueshmërinë Gjuhësore në Komuna*, mars 2019, në dispozicion në: http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/ENG-MT_Raport-Municipalities.pdf (qasur më 27 prill 2020).

synon, mes tjerash, krijimin e një baze ligjore për hierarkinë e ligjeve dhe korrigjimin administrativ të gabimeve gjuhësore në legjislacionin në fuqi dhe konsolidimin e teksteve ligjore. Miratimi eventual i projektligjit do të kontribuojë ndjeshëm në cilësinë e legjislacionit në Kosovë, përfshirë edhe nga këndvështrimi gjuhësor.

Sistemi Gjyqësor

Në Shtator 2019, KGJK miratoi Rregulloren nr. 07/2019 *për certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë*, duke siguruar kështu që përkthyesit dhe interpretët gjyqësorë për gjuhët zyrtare dhe gjuhët e tjera do të certifikoheshin nga KGJK. Në dhjetor 2019, KGJK shpalli një thirrje të hapur për aplikime për profesionistë/ekspertë të gjuhës, të cilët do të jenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit të KGJK-së për të certifikuar përkthyesit dhe interpretët gjyqësorë për çiftet gjuhësore shqip/serbisht, si dhe serbisht/anglisht. Në dhjetor 2019, Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), me mbështetje të OSBE-së, përktheu Statutin dhe Kodin e Etikës Profesionale të avokatëve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe, duke mundësuar kështu qasje në dokumentet kryesore të brendshme të OAK për avokatët që flasin serbisht.

Monitorimi i gjykimeve

OSBE-ja kreu monitorim të gjykimeve, në sistemin e drejtësisë përgjatë tërë periudhës raportuese. Ajo vërejti mangësi në ofrimin e shërbimeve kompetente dhe profesionale të përkthimit në sistemin prokurorial dhe gjyqësor. Përkthyesit e gjykatave nuk ishin në gjendje të përmbushin ngarkesën për përkthim me shkrim. Si pasojë, palët nga komunitetet joshqiptare pranonin njoftimet, thirrjet, procesverbalet e seancave dhe gjykimeve vetëm në gjuhën shqipe. Tabelat e njoftimeve publike dhe kalendarët e rasteve në gjykata nuk ishin gjithmonë të postuara në të gjitha gjuhët e kërkuara.

Incizimet joadekuate të seancave gjyqësore janë shqetësim tjetër gjuhësor. Në Departamentin e Krimeve të Rënda shumë seanca dëgjimore të monitoruara nuk janë incizuar si duhet. Janë kërkuar përkthime për një numër të konsiderueshëm të këtyre seancave të incizuara në mënyrë joadekuate. Nëse seanca nuk incizohet si duhet, mund të lindin vështirësi për të verifikuar nëse shërbimet e përkthimit ishin të sakta ose nëse gabimet në komunikim kufizuan qasjen e plotë të një pale në gjykatë dhe aftësinë e saj për të paraqitur në mënyrë efektive rastin, ose nëse ka pasur shkelje të rënda të së drejtës për gjykim të drejtë.

Policia e Kosovës

Raporti i fundit i OSBE-së për pajtueshmërinë gjuhësore në PK⁷⁵ konstatoi se ligji për përdorimin e gjuhëve ende nuk zbatohet plotësisht në të gjitha fushat nga PK. Për shkak

⁷⁵ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Pajtueshmëria gjuhësore në Kosovë, shtator 2018*, në dispozicion në: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/396821?download=true> (qasur më 27 prill 2020).

të presionit kohor dhe mungesës së një sistemi efektiv të përkthimit, dokumentet, si planet operative, nuk u përkthyen në kohën e duhur. Komunikimi midis drejtorive rajonale të PK-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme ishte sfidues, veçanërisht me rajonin e PK-së në Mitrovicë të Veriut, kryesisht me zyrtarë që flasin serbisht, në krahasim me Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së që kryesisht ka personel shqipfolës.

Raporti konstaton se niveli i respektimit gjuhësor në PK është përmirësuar ndjeshëm, krahasuar me vlerësimet e mëparshme, por që disa fusha kërkojnë analiza të mëtejshme dhe veprime korigjuese nga menaxhmenti i PK-së. Rekomandimet për PK të përfshira në raport përfshijnë: përmirësimin e praktikave dhe procedurave aktuale të përkthimit me shkrim; organizimin e kurseve të gjuhës shqipe dhe serbe për gjeneratat e reja të zyrtarëve policorë; rritjen e fondeve për të punësuar më shumë përkthyes; sigurimin që shenjat e dyerve të brendshme të janë në të dy gjuhët zyrtare; përkthimin e të gjitha dokumenteve me shkrim në gjuhët zyrtare dhe sigurimin e shpërndarjes e tyre në zyrat vartëse; krijimin e një grupi përkthyesish për adresimin e efektshëm të nevojave të përkthimit; dhe rritjen e numrit të përkthyesëve gra.

Në qershor të vitit 2019, OSBE-ja rivlerësoi situatën në të tetë rajonet e PK-së në lidhje me pajtueshmërinë gjuhësore dhe arriti në përfundimin se nuk ka pasur përmirësime të ndjeshme që nga publikimi i raportit për vitin 2018.

Pjesa e katërt: Qasja në drejtësi, performanca e sektorit të drejtësisë dhe përfaqësimi i komuniteteve në sektorin e drejtësisë

Rekomandime nga Rezoluta e KiE:

“Të adresohen pabarazitë në qasjen në drejtësi mes shumicës shqiptare dhe pakicave; të harmonizohet përdorimi i gjuhës serbe në procedurat gjyqësore dhe administrative me dispozitat e legjislacionit përkatës që rregullon përdorimin e gjuhëve në proceset që përfshijnë komunitetet joshumicë; të rritet edhe më shumë prania e gjyqtarëve, avokatëve dhe stafit mbështetës joshqiptar.

Të merren hapa për të siguruar që rastet e kthimit të pronave, në veçanti riuzurpimi i paligjshëm, të hetohen me shpejtësi, ndiqen penalisht në mënyrë të duhur, dhe trajtohen nga gjykatat në kohën e duhur dhe të sanksionohen në mënyrë meritore për të qenë shembull i mjetit efektiv dhe parandalues.”

Përbërja etnike e gjyqësorit

Botimi i 4-të i RVDK theksoi mungesën e besimit të komuniteteve joshumicë në sistemin e drejtësisë dhe rekomandoi punësimin e stafit gjyqësor dhe prokurorial nga komunitetet joshumicë. Përbërja etnike e sistemit të drejtësisë tani është dukshëm e ndryshme për shkak të integritimit gjyqësor sipas Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësi.⁷⁶

Me 24 tetor 2017, përmes një dekreti, Presidenti emëroi 40 gjyqtarë dhe 13 prokurorë që duhej të integroheshin në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Pesë nga gjyqtarët e integruar u caktuan në Gjykatën Themelore në Gjilan, përfshirë degët e Gjykatave në Kamenicë dhe Viti, dhe një ishte caktuar në degën e Shtërpcës të Gjykatës Themelore të Ferizajt.⁷⁷ Gjykatësit e tjerë u caktuan në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Njëkohësisht, personeli ndihmës serb i gjyqësorit nënshkroi kontratat përkatëse në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Më 31 tetor 2017, KGJK zgjodhi z. Nikola Kabashiq, gjyqtar serb, për Kryetar të ri të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.

Në dhjetor 2017, pjesëtarë të gjyqësorit, Policisë së Kosovës dhe Odës së Avokatëve organizuan një takim në Mitrovicë të Veriut. Ky ishte takimi i parë i këtij lloji që nga integrimi i gjyqësorit. Pjesëmarrësit diskutuan për qasjen në drejtësi për të gjithë dhe

⁷⁶ Marrëveshja e Parë e Parimeve e arritur midis Prishtinës dhe Beogradit më 19 prill 2013, me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Pika dhjetë e Marrëveshjes thekson se “Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe veprojnë brenda kornizës ligjore të Kosovës”.

⁷⁷ Të pesë gjyqtarët e caktuar në Gjykatën Themelore në Gjilan janë serbë; gjyqtari i caktuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj është Goran.

emërimin e avokatëve *sipas detyrës zyrtare* për palët që nuk kanë mundësi të paguajnë avokat.⁷⁸

Në vitin 2018, për të promovuar qëndrueshmërinë e integritit, Oda e Avokatëve të Kosovës organizoi program të punës praktike, me mbështetje të OSBE-së, për juristët e sapodiplomuar serbë në zyrat e avokatëve në veri të Kosovës. Në prill 2018, gjashtë të diplomuar përfunduan programin, duke përmbushur kriteret për të hyrë në provimin e jurisprudencës. Në maj të vitit 2018, Oda e Avokatëve të Kosovës shpalli thirrjen e dytë për praktikantë. Shtatë juristë të diplomuar nga veriu i Kosovës u pranuan për ciklin e dytë të programit të praktikës. Brezi i tretë që përfshin tetë të diplomuar do të përfundojë praktikën në tetor 2020. Deri në fund të periudhës së raportimit, katër të diplomuar nga 13 hynë në provimin e jurisprudencës, dhe tre (të gjitha gra) e kaluan atë në herën e parë.

Integrimi i gjyqësorit vazhdon pa probleme dhe shumë prej pengesave për qasje në drejtësi janë hequr. Në fund të vitit 2019, ishin 422 gjyqtarë: 369 shqiptarë, 43 serbë, 8 boshnjakë, një rom dhe një goran.

Ngarkesa me lëndë

Botimi i 4-të i RVDK gjithashtu vuri në dukje se numri i konsiderueshëm i rasteve të pazgjidhura kishte çuar në vonesa në gjykimin e lëndëve, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me pronën. OSBE-ja vë në dukje se në vitin 2018, gjyqësori kishte 425.614 raste të procedim, nga të cilat 307.513 ishin trashëguar nga viti 2017 si lëndë të pazgjidhura. Gjatë vitit 2018, gjykatat pranuan 118.401 lëndë dhe përfunduan 180,290 lëndë. Në lidhje me lëndët e pazgjidhura në gjyqësor në vitin 2019, statistikat tregojnë rënie prej 10.44 për qind. Gjatë vitit 2019, ngarkesa me lëndë arriti në 360,806: 245.477 lëndë u trashëguan nga vitet e kaluara, ndërsa 115.359 ishin lëndë të reja. Më 2019, gjykatat zgjidhën 143.650 lëndë, ndërsa 216.899 lëndë mbeten për t'u proceduar.⁷⁹ Rekomandimi nga publikimi i 4-të i RVDK për "marrjen e masave aktive për të zvogëluar numrin e vazhdueshëm të lëndëve" vlen ende. Përkundër përparimit gradual, por të qëndrueshëm, në zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura, gjyqësori duhet të përdorë një sistem më të efektshëm të menaxhimit të lëndëve në mënyrë që të zvogëlojë më shpejtë numrin e lëndëve të pazgjidhura.

Çështjet gjuhësore

Sistemi i drejtësisë vazhdon të përballet me vështirësi në zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.⁸⁰ Monitorimi i gjykatës nga OSBE-ja ka vërejtur një mungesë

⁷⁸ Emërimet *sipas detyrës zyrtare* në rastet penale administrohen nga Oda e Avokatëve të Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial të Kosovës dhe Policinë e Kosovës, ndërsa Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, në bazë të Ligjit për ndihmë juridike falas, është përgjegjëse për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas në të gjithë Kosovën.

⁷⁹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti Vjetor për Statistikat e Gjykatës*, 2019, në <https://www.gjyqesori-rks.org/raportet/> (qasur më 10 qershor 2020).

⁸⁰ [Shih](#) shënimin sipër69.

përkthimi, ose përkthim nën standard gjatë disa rasteve gjyqësore, në kundërshtim me të drejtën vendore⁸¹ dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁸² Në shumë raste, vëzhguesit e gjykatave raportuan se në rastet me gjyqtar shqiptar dhe palë serbe, procesverbali përgatitej në gjuhën shqipe, dhe anasjelltas. Në situata të tilla, palët nënshkruajnë procesverbalet në një gjuhë që ata nuk mund ta kuptojnë. Për më tepër, përkthimi i legjislacionit në të dy gjuhët zyrtare mbetet sfidë, duke ndikuar edhe në qasjen në drejtësi edhe në funksionalitetin e plotë të gjyqësorit të integruar. Në nëntor 2018, Zyra e Komisionerit të Gjuhëve dhe Zyra Ligjore e Kryeministrit organizuan konferencë për të diskutuar rekomandimet nga raporti i OSBE-së për “Legjislacionin dygjuhësh në Kosovë”.⁸³

Transaksionet e rrejshme të pronave

Në fund, për sa i përket të drejtave pronësore të komuniteteve, transaksione të rrejshme penale dhe civile të pronave janë regjistruar në të gjitha gjykatat e Kosovës dhe janë veçanërisht të pranishme në rajonin e Pejës.⁸⁴ Mes viteve 2010 dhe 2019, 1.516 lëndë penale të transaksioneve të rrejshme të pronave janë shqyrtuar në gjykatat e rajonit të Pejës. Numri i lartë i lëndëve të shqyrtuara tregon se qasja në drejtësi është përmirësuar; megjithatë kjo gjithashtu demonstroi vazhdimin e këtij problemi, që është pengesë për procesin e pajtimit dhe kthimit. Analiza e monitorimit të gjykatave nga OSBE e rreth 400 rasteve civile dhe penale të uzurpimit të pronave zbuloi shqetësime që kanë të bëjnë kryesisht me praktikën e thirrjeve të parregullta, shërbime të mangëta të përkthimit,⁸⁵ mungesa të shpeshta të palëve, mosrespektim të afateve ligjore dhe performancë e dobët e avokatëve dhe /ose përfaqësuesve të përkohshëm të caktuar për rastin.

⁸¹ E drejta për barazi të gjuhëve zyrtare, shqipe dhe serbe, është e drejtë kushtetuese e garantuar me nenin 5 të kushtetutës.

⁸² Neni 6(3)(e) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shihni gjithashtu Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, të miratuar nga Këshilli i Evropës më 5 nëntor 1992.

⁸³ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Legjislacioni dygjuhësh në Kosovë, shtator 2018*, në dispozicion në: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/396836> (qasur më 15 maj 2020). Raporti ofron një pasqyrim të procesit aktual të hartimit të legjislacionit dygjuhësor në nivel të qeverisë dhe kuvendit në mënyrë që të nxjerrë në pah mangësitë procedurale dhe praktike dhe të japë rekomandime për të përmirësuar procesin e përpilimit dhe përkthimit dygjuhësh dhe të forcoj zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

⁸⁴ Veprat përfshijnë uzurpimin e paligjshëm të pronës, mashtrimin, shkeljen e besimit, falsifikimin e dokumenteve, raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve dhe legalizimin e përmbajtjes së rrejshme.

⁸⁵ Sigurimi i shërbimeve gjuhësore është një nga shqetësimet më urgjente në rastet e transaksioneve të paligjshme të pronave, veçanërisht atyre që përfshijnë palë serbe.

Pjesa e pestë: Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut (Institucioni i Avokatit të Popullit)

Rekomandimi nga Rezoluta e KiE:

"Të bëhet e mundur që Institucioni i Avokatit të Popullit të funksionojë si duhet, duke e pajisur me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të realizuar mandatin e tij, përfshirë ndërgjegjësimin, si dhe duke siguruar zbatim efektiv të rekomandimeve të tij."

Struktura dhe funksionimi

Në qershor të vitit 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi një pako të legjislacionit për të drejtat e njeriut, gjegjësisht ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, ligjin për Avokatin e Popullit dhe ligjin për barazinë gjinore.⁸⁶ Pas kësaj, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë (IAP) miratoi aktet nënligjore që qeverisin rregullat e brendshme dhe organizimin e tij në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit.⁸⁷ Më 2016, IAP iu nënshtrua ristrukturimit dhe themeloi shtatë departamente⁸⁸: Departamenti i Pranimit dhe Administrimit të Ankesave, Departamenti i Hetimeve të Ankesave, Departamenti për Mbrojtje nga Diskriminimi, Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Departamenti për Parandalimin e Torturës, Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Bashkëpunim, Raportim dhe Promovim të të Drejtave të Njeriut.⁸⁹

Mandati i zëvendësve në largim të Avokatit të Popullit skadoi në tetor 2014; por megjithatë ata mbetën në detyrë deri në zgjedhjen e zëvendësve të ri të Avokatit të Popullit. Pesë zëvendës të rinj (një grua serbe, tre gra shqiptare dhe një burrë shqiptar) u emëruan nga Kuvendi i Kosovës⁹⁰ në janar 2018. Institucioni aktualisht ka staf të plotë.

Që nga publikimi i botimit të 4-të të RVDK, IAP u zhvendos nga lokalet me qira në një ndërtesë qeveritare, duke zgjidhur çështjen e objektit të zyrës qendrore. Buxheti vjetor i IAP është rritur që nga viti 2016⁹¹ bazuar në nevojat dhe planifikimin e buxhetit. Që nga viti 2018 është rreth 1.3 milion Euro në vit.⁹² IAP gjithashtu merr mbështetje të jashtme

⁸⁶ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligji nr. 05/L-020 për barazinë gjinore dhe Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi.

⁸⁷ Më 25 mars 2016, u miratua Rregullorja nr. 01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit; më 26 maj 2016, u miratua Rregullorja nr. 02/2016 për Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit.

⁸⁸ Lista e të gjitha departamenteve dhe detyrat e tyre mund të gjenden në <https://www.oik-rks.org/en/>.

⁸⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor për 2016, 2017*, në dispozicion në: https://oik-rks.org/wp-content/uploads/old_doc/Raporti_Vjetor_2016_ANG_no16_me_kopertine_per_web_338158.pdf. (qasur më 15 maj 2020)

⁹⁰ Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

⁹¹ Buxheti vjetor i IAP për vitin 2016 ishte 996,389.98 Euro dhe 932.147.02 Euro për 2015, [shih](#) shënimin sipër 89.

⁹² Në tre vitet e fundit, buxheti vjetor i IAP është midis 1,373,167.00 (2018) dhe 1,373,815.00 në vitin 2020 (<https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2,16>).

në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë një projekt dy-vjeçar të mbështetur nga Këshilli i Evropës për forcimin e Mekanizmit Parandalues Kombëtar kundër Torturës⁹³ dhe një projekt tre vjet e gjysmë i financuar nga Bashkimi Evropian me titull “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë”.⁹⁴

Hetimet, rekomandimet, aktivitetet

Hetimi i shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut bazuar në ankesat individuale dhe raportet zyrtare mbetet përgjegjësi kryesore e IAP. Mes 2016 dhe 2018, IAP mori një numër të ankesave çdo vit.⁹⁵ Numri i ankesave të papranueshme u ul nga 75 për qind në 2015 në 51 për qind më 2019⁹⁶ për shkak të angazhimit më të mirë të IAP, kontaktit në terren dhe rritjes së dukshmërisë. Ankesat u konsideruan të papranueshme sepse 1) nuk ishin shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion; 2) nuk ishte identifikuar asnjë shkelje; ose 3) ankesa ishte jashtë kompetencave të IAP.

Në vitin 2018, IAP dyfishoi numrin e rekomandimeve që ia kishte dhënë institucioneve të ndryshme komunale dhe qeveritare, përfshirë ministrive të ndryshme, komunave, universiteteve dhe gjykatave, në krahasim me vitin 2017.⁹⁷ Sidoqoftë, zbatimi i rekomandimeve të përmendura mbetet sfidë. Në vitin 2017, 41 (30.8 për qind) rekomandime u zbatuan plotësisht, 40 (30.07 për qind) nuk u zbatuan fare dhe 52 (39 për qind) ishin në pritje të zbatimit. Në vitin 2018, 99 (37.64 për qind) rekomandime u zbatuan plotësisht, 29 (11.02 për qind) nuk u zbatuan fare dhe 135 (51.33 për qind) ishin në pritje të zbatimit. Në vitin 2019, IAP lëshoi 225 rekomandime për institucione të ndryshme, nga të cilat 55 rekomandime (24.45 për qind) u zbatuan, 12 (ose 5.33 për qind) nuk u zbatuan fare dhe 158 (70.22 për qind) janë në pritje të zbatimit. Zbatimi i rekomandimeve të IAP është tregues i progresit të Kontratës së Reformave Sektoriale në Administratën Publike brenda Instrumentit të BE-së për Ndhimën e Para-Anëtarësimin (IPA). Një nga treguesit e IPA kërkon që të paktën 70 për qind e rekomandimeve drejtuar institucioneve qeveritare

⁹³ Forcimi i Mekanizmit Parandalues të Kosovës i mbështetur nga Këshilli i Evropës, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Norvegjeze, i zbatuar nga Këshilli i Evropës u implementua nga 1 maji 2017 deri më 30 prill 2019.

⁹⁴ Qëllimi i projektit, i cili filloi në 4 mars 2019, është forcimi i kapaciteteve të IAP për të mbrojtur dhe promovuar në mënyrë efektive të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në Kosovë.

⁹⁵ Në vitin 2016, IAP pranoi 1,694 ankesa, nga të cilat 87.4 për qind (1,481) ishin iniciuar nga komuniteti shqiptar i Kosovës dhe 12.6 për qind nga komunitetet në pakicë numerike (101 nga serbët e Kosovës, 27 nga ashkalitë, 23 nga boshnjakët, 21 nga egjiptianët, 19 nga romët, 16 nga turqit dhe gjashtë nga të tjerët). Në vitin 2017, IAP pranoi 1,863 ankesa, nga të cilat 87.4 për qind (1,628) u inicuan nga komuniteti shqiptar dhe 12.6 për qind nga komunitetet në pakicë numerike (101 nga serbët, 26 nga boshnjakët, 25 nga turqit, 25 nga ashkalitë, 24 nga egjiptianët, 22 nga romët dhe 12 nga të tjerët). Në vitin 2018, IAP pranoi 1,986 ankesa, nga të cilat 89 për qind (1,767) u inicuan nga komuniteti shqiptar dhe 11 për qind nga komunitetet në pakicë numerike (112 nga serbët, 28 nga boshnjakët, 28 nga romët, 17 nga boshnjakët, 14 nga egjiptianët, 11 nga turqit dhe 9 nga të tjerët). Në vitin 2019, IAP pranoi 1,214 ankesa, nga të cilat 89.87 për qind nga komuniteti shqiptar dhe 10.13 për qind nga komunitetet në pakicë numerike (91 nga serbët, 28 nga boshnjakët, 24 nga ashkalitë, 21 nga romët, 20 nga egjiptianët, 12 nga turqit dhe 8 nga të tjerët). Burimi: Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor për 2016, 2017, 2018 dhe 2019*.

⁹⁶ Institucioni i Avokatit të Popullit, *raporti vjetor 2019, 2020 në: <https://www.oik-rks.org/en/2020/04/02/godisnji-izvestaj-2019/>* (qasur më 10 qershor 2020), f. 178

⁹⁷ IAP lëshoi 133 rekomandime më 2017 dhe 263 rekomandime më 2018. Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor për 2018, 2019, në dispozicion në: <https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/04/Annual-report2018.pdf>* (qasur më 15 maj 2020).

të marrin përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve.⁹⁸ Sidoqoftë, IAP merr përgjigje vetëm në 35 për qind të rasteve.⁹⁹

IAP është duke marrë rol më proaktiv në organizimin e veprimtarive promovuese, në mënyrë të pavarur ose me mbështetjen e palëve ndërkombëtare të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile. Në vitin 2018, IAP organizoi dhjetë aktivitete kontaktimi me mbështetje nga OSBE të cilat përfshinin të rinjtë në Kosovë. Tri nga ngjarjet ishin enkas për të rinjtë nga komunitetet joshumicë: serbët, romët, ashkalitë dhe egjiptianët në Graçanicë, boshnjakët dhe goranët në Dragash dhe turqit në Prizren. Pas punëtorisë në Prizren, IAP filloi një hulumtim lidhur me përdorimin e gjuhës turke në librat shkollorë. Ky problem nuk është zgjidhur brenda periudhës së raportimit.¹⁰⁰

Në vitin 2018, IAP lansoi dy publikime, *"Manuali për Mbrojtjen nga Diskriminimi"* dhe *"Parimet e administrimit të mirë - Përmbledhje nga Avokati i Popullit"*,¹⁰¹ dhe një seri videosh promovuese për të drejtat e grupeve të ndryshme të cenueshme, përfshirë gratë, të rinjtë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet joshumicë. IAP bashkëpunoi në mënyrë produktive me organizatat e shoqërisë civile në hartimin e planit të veprimit për reagimet e përbashkëta kundër diskriminimit dhe jolerancës, dhe krijimin e një platforme të përbashkët në uebfaqen e IAP për shkëmbimin e publikimeve për të drejtat e njeriut.

Sfidat e mbetura

IAP ende përballet me disa sfida në komunikimin me komunitetet joshumicë, pavarësisht se ka zyra rajonale në Mitrovicë të Veriut dhe Graçanicë me serbë të punësuar.

Trajtimi i rasteve të diskriminimit, përfshirë diskriminimin në sektorin privat, mbetet sfida për Institucionin. IAP nxjerr rekomandime për institucionet përkatëse dhe opinione ligjore *amicus curie* për gjykatat mbi shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, vetëm disa raste të diskriminimit janë inicuar në dy vitet e fundit. Ekziston nevojë e vazhdueshme për ndërgjegjësimin e banorëve për diskriminimin dhe për t'i ndërtuar kapacitetet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, zyrtarëve ministrorë dhe komunalë për çështjet e diskriminimit, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara për adresimin e rasteve të diskriminimit.

⁹⁸ *Marrëveshja financiare për IPA 2016, Pjesa e dytë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian*, 2017, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707> (qasur më 10 qershor 2020), f. 46. Detyrimi për t'u përgjigjur brenda 30 ditëve përcaktohet edhe me nenin 28 të ligjit për Avokatin e Popullit.

⁹⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor 2019*, shënimi sipër 96, f.183.

¹⁰⁰ Po aty, f. 87. "Ende nuk ka rezultate në zgjidhjen e problemit lidhur me tekstet shkollore cilësore në boshnjakisht dhe turqisht, kështu që ky problem është akoma i pranishëm në të gjitha nivelet e arsimit. Çështja ka të bëjë me përkthimin e dobët të teksteve shkollore ose disponueshmërinë e teksteve shkollore për klasat e larta të arsimit fillor dhe të mesëm. Pjesëtarët e komunitetit turk dhe atij boshnjak vazhdojnë të kenë ankesa për mësimin e shqipes në arsimin fillor dhe të mesëm meqë nxënësit gjatë shkollimit në gjuhën e tyre amtare nuk marrin njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe."

¹⁰¹ Nuk është në internet.

Vendndodhja e disa zyrave rajonale mbetet sfidë. Për shembull, në gusht 2019, komuna e Gjilanit përkohësisht largoi zyrën e IAP nga ndërtesa komunale gjatë rinovimit të ndërtesës. Stafi i IAP kishte punuar nga shtëpia dhe takohej me homologët dhe ankuesit në kafene dhe restorante derisa rinovimi përfundoi në janar 2020 dhe zyra në ndërtesën komunale ishte përsëri e përdorshme. Në Mitrovicë të Jugut, zyra rajonale është e vendosur në katin e dytë të ndërtesës komunale pa ashensor, duke kufizuar qasjen për të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara.

Pjesa gjashtë: Trashëgimia fetare dhe kulturore

Rekomandimi nga Rezoluta e KiE:

“Të vazhdohet forcimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në konsultim me të gjitha komunitetet, veçanërisht trashëgiminë kulturore dhe fetare serbe, në mënyrë që të parandalohet çdo përpjekje për shpërdorim të saj; të forcohen edhe reagimet ndaj ndërtimeve dhe aktiviteteve të paligjshme duke adresuar mangësitë në kornizën ligjore dhe të politikave; të mbrohet dhe respektohet diversiteti kulturor dhe tu mundësohet komuniteteve pakicë të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre, përfshirë përmes krijimit të një mekanizmi transparent të ndarjes së fondeve për ruajtjen e kulturave dhe identiteteve të pakicave”.

Avancimi i kornizës ligjore dhe të politikave

Gjatë periudhës raportuese, qeveria miratoi Strategjinë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (2017 - 2027),¹⁰² duke sjellë një dokument të ri politikash në këtë fushë. Kjo strategji synon të mbrojë trashëgiminë kulturore të të gjitha komuniteteve dhe të shërbejë si mjet kryesor për të forcuar kornizën normative dhe institucionale. Qëllimet e Strategjisë janë zhvillimi i një qasjeje të integruar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duke promovuar pjesëmarrjen e publikut dhe edukimin në procesin e vendimmarrjes. Kjo, për shembull, është vërejtur në procesin e hartimit të Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike në Prizren. Më 6 korrik 2018, qeveria miratoi Konceptdokumentin për trashëgiminë kulturore, duke përfunduar kështu kornizën e politikave. Konceptdokumenti ofron bazën ligjore për të ndryshuar dhe plotësuar ligjin ekzistues për trashëgiminë kulturore.¹⁰³ Miratimi i tij ishte zhvillim pozitiv për ndryshim-plotësimin e mundshëm të ligjit në të ardhmen.

Monitorimi i OSBE-së gjithashtu identifikoi përparimin në konsolidimin e kornizës institucionale. Për shembull, në vitin 2018, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) themeloi Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore - një mekanizëm që kishte humbur që nga shpallja e Ligjit për trashëgiminë kulturore. Andaj, korniza institucionale ka fituar një mundësi operacionale për të kryer vizita dhe monitoruar objektet e trashëgimisë kulturore. Inspektorati është menduar të marrë masa të përshtatshme për të mbrojtur objektet e trashëgimisë. Megjithatë, numri i inspektorëve që janë duke punuar aktualisht nuk është i mjaftueshëm për t'i adresuar të gjitha problemet.¹⁰⁴

Miratimi i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe ka mbyllur hendekun normativ në legjislacionin e trashëgimisë kulturore. Për më tepër, mekanizmat e krijuar për të lehtësuar zbatimin e ligjeve të ndryshme të trashëgimisë

¹⁰² Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, *Strategjia për trashëgiminë kulturore 2017 - 2027*, 2016, në dispozicion në: https://mkrs-ks.org/repository/docs/eng_strategy_for_heritage.pdf (qasur më 15 maj 2020).

¹⁰³ Ligji nr. 02/L-88 për qasjen në dokumente publike, 6 nëntor 2006.

¹⁰⁴ Aktualisht janë vetëm dy inspektorë të trashëgimisë kulturore.

kulturore kanë shënuar përparim të rëndësishëm. Në maj të vitit 2019, kuvendi komunal i Prizrenit votoi në favor të themelimit të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit. Për më tepër, këshillat lokalë për Qendrën Historike në Prizren dhe Hoçën e Madhe kanë vazhduar të mbajnë takime të rregullta dhe janë aktivë, duke treguar një trend pozitiv të koordinimit të menaxhimit të dy zonave.¹⁰⁵

Zonat e veçanta të mbrojtura

Në një shënim tjetër pozitiv, pas gati dy vitesh pasivitet, Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM) filloi me takime të rregullta më 2018.¹⁰⁶ Gjatë takimeve të tij, KZM diskutoi për çështje të ndjeshme që kishin vështirësuar marrëdhëniet midis Kishës Ortodokse Serbe (KOS) dhe institucioneve të Kosovës. Kjo përfshinte planin kontestues për ndërtimin e një rruge rajonale midis komunës Deçanit dhe Plavës (Mal i Zi), që prekë zonën e veçantë të mbrojtur të Manastirit të Deçanit (ZVM), dhe refuzimin e vazhdueshëm të komunës së Deçanit për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese që afirmonte të drejtat e pronësisë së tokës në favor të Manastirit.¹⁰⁷ Sidoqoftë, Misioni i OSBE-së në Kosovë vuri në dukje progresin në komunat e tjera, ku KOS u konsultua në kohën e duhur.¹⁰⁸ Raste të tilla ilustrojnë shembuj pozitivë të pajtueshmërisë institucionale me legjislacionin për ZVM.¹⁰⁹ Sidoqoftë, duke pasur parasysh situatën e brishtë politike, veprimet e njëanshme ad hok të institucioneve të Kosovës në lidhje me vendet e ZVM kanë pasur ndikim negativ në situatën e përgjithshme.

Përfundimisht MKRS ka vazhduar me përditësimin e listës vjetore të vendeve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme. Sidoqoftë, monitorimi i OSBE-së ka identifikuar disa incidente të përsëritura që kanë prekur rëndë disa asete të trashëgimisë në mbrojtje të përkohshme, përfshirë pronarë që kanë shkatërruar pasuri të trashëgimisë.¹¹⁰ Në këtë kontekst, monitorimi i zhvillimeve në vendet e ZVM është ende me rëndësi të madhe.

¹⁰⁵ Të dy këshillat janë themeluar në bazë të Ligjit nr. 2011/04-L-062 për Hoçën e Madhe, 18 korrik 2012, dhe ligjit nr. 2011/04-L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, 18 korrik 2012, si mekanizma lokalë për të mbrojtur interesat e të gjitha komuniteteve në menaxhimin e këtyre dy zonave të rëndësishme të trashëgimisë historike dhe kulturore dhe për t'i ruajtur ato nga zhvillimet e dëmshme.

¹⁰⁶ Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, 4 qershor 2008, përcakton KZM-në si organ për monitorimin dhe lehtësimin e zbatimit të këtij ligji. Gjatë periudhës së raportimit, KZM është mbledhur 11 herë, së fundi më 10 prill 2019.

¹⁰⁷ Në maj të vitit 2016, Gjykata Kushtetuese nxori një vendim që afirmonte të drejtat e pronësisë së Manastirit të Deçanit mbi 24 hektarë tokë në afërsi të saj.

¹⁰⁸ Për shembull, në shkurt 2017, komuna e Lipjanit e informoi KOS për një kërkesë të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e zyrave administrative. Ndërtimi i planifikuar do të kishte ndikim tek ZVM të Kishës së Paraqitjes së Virgjëreshës SPZ në Lipjan. KOS nuk u pajtua me ndërtimin dhe çështja aktualisht po diskutohet me KZM.

¹⁰⁹ Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, 4 qershor 2008.

¹¹⁰ Rrënimi i paligjshëm i bujtinës Mullafazliu (monumenti i mbrojtur) në Qendrën Historike Prizren, ZVM, ndodhi më 2015. Rrënimi i paligjshëm i shtëpisë së familjes Myftiu (monumenti i mbrojtur) në Qendrën Historike Prizren, ZVM, ndodhi më dhjetor 2017. Më 11 korrik 2019, Gjykata Themelore e Prizrenit e shpalli fajtor pronarin. Pas pranimit të fajësisë, gjykata e dënoi me gjobë 700 euro. Rrënimi i paligjshëm i shtëpisë Hisari në Qendrën Historike Prizren, ZVM, ndodhi më mars 2018. Seanca gjyqësore u mbajt para Gjykatës Themelore të Prizrenit më 30 janar 2019. Pronari lidhi marrëveshje të pranimit të fajësisë dhe u dënua me gjobë monetare në shumë prej 300 Euro. Më 15 prill 2018, stafi i Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Pejë vuri re se shtëpia "Ramiz Sadiku", brenda listës së MKRS-së të vendeve nën mbrojtje të përkohshme, ishte rrënuar plotësisht. Rasti iu referua gjykatës për procedura të mëtejshme

Sfidat e mbetura

Meqë çdo ndryshim i mundshëm i ardhshëm në Ligjin për trashëgiminë kulturore do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në marrëdhëniet ndëretnike ashtu edhe në të drejtat e komuniteteve për ta gëzuar trashëgiminë e tyre dhe për të përfituar nga ajo, ky proces duhet të sigurojë konsultim të të gjitha komuniteteve dhe grupeve fetare. Institucionet komunale dhe qeveritare duhet të vazhdojnë të komunikojnë në mënyrë efektive me KOS para se të ndërmarrin punë publike brenda vendeve të ZVM. Çështja e ndërtimeve të paligjshme dhe rrënitit të monumenteve të mbrojtura nuk është trajtuar plotësisht. Kërkohen masa dhe mjete parandaluese shtesë për të siguruar mbrojtje efektive të të gjitha vendeve të trashëgimisë kulturore në tërë Kosovën. Institucionet komunale dhe qeveritare duhet ta rrisin monitorimin dhe vizitat në terren, si dhe t'i përmirësojnë udhëzimet në nivelin e qeverisë për adresimin e mangësive të vërejtura. Sistemi i drejtësisë duhet të vazhdojë të hetojë, ndjekë penalisht dhe gjykojë rastet që kanë të bëjnë me dëmtimin dhe shkatërrimin e vendeve të trashëgimisë kulturore, për të siguruar mbrojtje të pasurive të trashëgimisë përmes zbatimit efektiv të legjislacionit të trashëgimisë kulturore.

dhe u gjykua në vitin 2020; gjykata e shpalli të pandehurin fajtor dhe shqiptoi gjobë prej 300 Euro. Më 06 shkurt 2019, Kullë (shtëpi e vjetër tradicionale prej guri) brenda listës së MKRS-së në mbrojtje të përkohshme dhe objekt i restaurimit të pjesëshëm publik më 2011, me lokacion në qytetin e Pejës, u rrënua nga pronari. Sipas drejtorit të QRTK, rrënimi ndodhi pa asnjë njoftim paraprak.

Pjesa e shtatë: Mediat në gjuhët e komuniteteve joshumicë

Rekomandimi nga Rezoluta e KiE:

“Të sigurohet mbështetje e duhur financiare për zhvillimin e mediave të dedikuara për të gjitha komunitetet pakicë; të ketë angazhim me mediat dhe organet rregullative për të promovuar të kuptuarit dhe raportimin më me shumë nuanca të fakteve për të shmangur nxitjen e tensioneve ndërmjet komuniteteve dhe polarizimin e mëtejshëm, përfshirë online, dhe rritje e mundësive të trajnimit për gazetarët”.

Mjedisi medial

Në Kosovë, në një treg të kufizuar të marketingut, funksionon një numër i madh i mediave. Burimet e të ardhurave komplikohen edhe më tej nga mungesa e transparencës në lidhje me pronësinë përfundimtare.¹¹¹ Kjo është veçanërisht akute për mediat rajonale, përfshirë mediat në gjuhë të komuniteteve joshumicë.¹¹² Nuk ka të dhëna të disponueshme për efektin e ndërhyrjeve të raportuara nga pronarët e mediave në autonominë editoriale, dhe të vetë-censurimit nga gazetarët, mbi pluralizmin e mediave - si brenda mediave ashtu edhe në peizazhin e mediave. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), autoriteti rregullativ i transmetimit, ka mandat, ndër të tjera, për të zbatuar dispozitat ligjore për mbulim të ekuilibruar politik.¹¹³ Sidoqoftë, KPM monitoron vetëm sigurimin e përmbajtjes gjatë zgjedhjeve.¹¹⁴ Prandaj, ka të dhëna të kufizuara për prirje politike të mediave audiovizive, përfshirë të transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) dhe mediave rajonale.

¹¹¹ Shih gjithashtu Freedom House, *Liria në botë 2019 - Kosova*, në dispozicion në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2019> (qasur më 15 maj 2020); IREX, *Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave 2019 Kosovë*, në: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-kosovo.pdf> (qasur më 15 maj 2020), f. 8, South East European Media Observatory, *Raport i integritetit medial: Pronësia dhe financimi i mediave në Kosovë*, 30 nëntor 2015, në dispozicion në: <https://web.archive.org/web/20190624135227/https://mediaobservatory.net/radar/media-integrity-report-media-ownership-and-financing-kosovo>, (qasur më 15 maj 2020).

¹¹² “Ekzistojnë shqetësime të veçanta në lidhje me lirinë e shprehjes në veriun e Kosovës, përfshirë vetë-censurimin.”: Raport i Komisionit Evropian, *Kosova 2019* 29 maj 2019, në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf> (qasur më 15 maj 2020), f. 25.

¹¹³ Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, 2 mars 2012, përcakton mandatin e KPM-së. Kodi i Etikës, i cili ka efekt juridik mbi Ofruesit e Shërbimeve Mediatike, përcakton se duhet të ketë “mbulim të ekuilibruar të rasteve të interesit publik dhe çështjeve kontraverse politike” me qëllim “që të sigurojë përfaqësim pluralist të pikëpamjeve, pa ndonjë privilegj për ndonjë parti politike, pikëpamje politike ose grup a individ” (Komisioni i Pavarur për Media, *Kodi Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike në Kosovë* I/MC-2016/03, në dispozicion në: <http://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1493714855.8029.docx> (qasur më 15 maj 2020), neni 6).

¹¹⁴ KPM monitoron zbatimin e nenit 48 të ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, 5 qershor 2008, i cili kërkon mbulim të drejtë dhe të barabartë të subjekteve politike nga të gjitha mediat. Por, KPM nuk monitoron zbatimin e nenit 6 të kodit të përmendur të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike në Kosovë.

Konsumimi i mediave

Televizioni është burimi kryesor i informacionit për banorët e Kosovës. Afro 73 për qind shikojnë TV çdo ditë, ndërsa vetëm 15 për qind dëgjojnë radio çdo ditë.¹¹⁵ Afro 87 për qind e banorëve të Kosovës “kurrë” ose “pothuajse kurrë” nuk lexojnë gazeta.¹¹⁶ Gjatë kohës *prime time* (6:30 - 8:30 pasdite), 48 për qind e shikuesve ndjekin lajmet.¹¹⁷ Komunitete të ndryshme tregojnë ndryshime të konsiderueshme të konsumimit të televizionit nga ana e tyre. Për shembull, 85 për qind e egjiptianëve shikojnë televizion çdo ditë në krahasim me 36 për qind të romëve.¹¹⁸ Kohëzgjatja e konsumimit ditor të televizionit gjithashtu ndryshon. Anëtarët e komunitetit egjiptian shikojnë mesatarisht dy orë dhe pesë minuta, ndërsa anëtarët e komunitetit goran shikojnë mesatarisht 30 minuta.¹¹⁹ Komunitete të ndryshme tregojnë gjithashtu ndryshime domethënëse në shfletimin e portaleve në internet, duke filluar nga një mesatare prej 53 minutash në ditë sa është ajo e egjiptianëve deri në pesë minuta në ditë sa është ajo e goranëve.¹²⁰

Një studim i matjes së audiencës së mediave, realizuar në nëntor 2019, konfirmon se anëtarët e komunitetit serb kryesisht shikojnë stacione televizive të Serbisë ose media rajonale që konsiderohen të jenë të financuara nga Serbia.¹²¹ ¹²² Vlerësimi arriti në përfundimin se komuniteti serb i konsideron mediat e Serbisë si më të besuara. Për më tepër, sondazhi tregon se komuniteti boshnjak dhe ai goran priren të shikojnë programe

¹¹⁵ Të dhënat nga një studim i matjes së audiencës në media të realizuar në nëntor 2019 që përfshin mbi 4,000 banorë.

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Pasuar nga emisione televizive dhe seriale (19 për qind), programe të tjera të çështjeve aktuale si debate, intervista, programe diskutimi (13 për qind), sporte (5 për qind), filma (4 për qind), programe kulturore (4 për qind), programe edukative (3 për qind) dhe muzikë (3 për qind) (Po aty).

¹¹⁸ Mesatarja ditore e konsumit të televizionit: egjiptianët - 85 për qind; shqiptarët - 74 për qind; turqit - 68 për qind; serbët - 65 për qind; ashkalitë - 65 për qind; boshnjakët - 56 për qind; goranët - 39 për qind; romët - 36 për qind (po aty)

¹¹⁹ Mesatarja ditore e kohëzgjatjes së konsumit të televizionit: egjiptianët - 2 orë 5 minuta; serbët - 1 orë 47 minuta; turqit - 1 orë 25 minuta; shqiptarët - 1 orë 7 minuta; ashkalitë - 53 minuta; romët - 43 minuta; boshnjakët - 41 minuta; goranët - 30 minuta (Po aty).

¹²⁰ Mesatarja ditore e hapjes së portaleve në internet: egjiptianët - 53 minuta; shqiptarët - 37 minuta; serbët - 34 minuta; turqit - 33 minuta; boshnjakët - 31 minuta; romët - 18 minuta; ashkalitë - 16 minuta; goranët - 5 minuta (po aty).

¹²¹ Gjithsej, 59.20 për qind e të intervistuarve thanë që shikojnë stacione televizive të Beogradit “çdo ditë”, ndërsa 64.10 për qind deklaruan se kurrë nuk e shikojnë RTK2. Mostra ishte 1.507 banorë në tërë Kosovën, ndërsa mostra e komunitetit serb ishte më e madhe. Rezultatet nuk u zbërthyen për komunitetet e tjera joshumicë.

¹²² Komisioni i Pavarur për Media kërkon që të licencuarit të tregojnë vetëm një pronar nominal. Informacioni i disponueshëm në uebfaqen e KPM nuk tregon burimet përfundimtare të financimit. Ndërmarrja publike “*Mreža Most*” që përfshin 6 media në Kosovë është themeluar dhe financuar nga Qeveria e Serbisë. Mediat kryesore janë *TV Most*, *Radio e TV Puls*, *Radio Kosovska Mitrovica* dhe *Radio e TV Gračanica*. Për më tepër, dekreti për themelimin e ndërmarrjes publike (në dispozicion në: http://demo.paragraf.rs/demo/combined/Old/t/t2013_08/t08_0154.htm?fbclid=IwAR3VrrlUp7y56y0FgOS2xaLkiWb7UwRC4jGmxYSCZKNljFE76sv37j38v0l) përkufizon aktivitetet e tij si ofrim të mbështetjes logjistike, teknike dhe profesionale për (çdo) media të gjuhës serbe në Kosovë. Monitorimi i mediave i realizuar nga Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së në Kosovë zbulojnë mbështetje të fortë për *Srpska Lista*, parti politike e lidhur ngushtë me partinë qeverisëse në Serbi nga *TV Most* dhe *Radio e TV Puls*. Gjatë Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës më 6 tetor, ndërmjet 25 shtatorit dhe 4 tetorit 2019 *TV Most* dhe *Radio e TV Puls* i dhanë 87 dhe 89 për qind, përkatësisht, të mbulimit lajmeve *Srpska Listës* (Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian në Kosovë 2019, *Raporti Final - Zgjedhjet e parakohshme legjislative*, në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/eueomkosovo2019_finalreport_en_withcover.pdf (qasur më 15 maj 2020), f. 32).

televizive të Serbisë,¹²³ ndërsa komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian priren të shikojnë programe televizive të Kosovës.¹²⁴ Komuniteti turk kryesisht shikon programe televizive të Turqisë.¹²⁵

Programimi për komunitetet

RTK transmeton programe të veçanta të komunitetit për komunitetet jo-shumicë si vijon: serbët, boshnjakët, turqit, romët, ashkalitë, egjiptianët dhe goranët.¹²⁶ Redaksia e gjuhës serbe, boshnjake, rome dhe turke transmeton gjithashtu edhe edicion 15-minutësh të lajmeve. RTK, si të gjithë transmetuesit në Kosovë, nuk gjenerojnë vlerësime zyrtare të shikuesve. Prandaj, nuk ka informacion në dispozicion se sa njerëz shikojnë programe të destinuara për komunitetet jo-shumicë dhe ndikimin e tyre. Mirëpo, gazetarët që punojnë me programin e RTK-së në gjuhën rome në vitin 2019 raportuan se lajmet shpërndahen në media sociale dhe se ata marrin reagime pozitive nga komuniteti.

Më 7 qershor 2019, gjatë një seance dëgjimore publike për projektligjin për transmetuesin publik të Kosovës, gazetarët që punojnë në programin e gjuhës serbe RTK shprehën shqetësimin se projektligji nuk përcakton përqindje fikse të buxhetit vjetor për programet në gjuhët jo-shumicë dhe për komunitetet jo-shumicë dhe që kjo mund të rrezikojë ekzistencën e tyre. Projektligji nuk është miratuar deri më tani. Gazetarët që punojnë në programet jo-shumicë raportuan gjithashtu kushte të vështira pune në krahasim me redaksitë e tjera të RTK-së.¹²⁷ Për më tepër, gazetarët do të preferonin të transmetojnë më shumë lajme të prodhuara nga dhe për komunitetet.

Edukimi medial

Edukimi dhe aftësimi për mediat, i mbështetur nga OSBE në disa aktivitete, ofroi strategji afatgjata për t'i kapërcyer narrativat ekzistuese brenda komunitetit shumicë dhe atyre jo-shumicë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh mungesën e transparencës në lidhje me pronësinë e mediave dhe mundësinë e paragjyimit të maskuar në raportim. Një edukim dhe trajnim i tillë u mundëson qytetarëve të vlerësojnë

¹²³ Komuniteti boshnjak më së shpeshti shikon TV PRVA (26 përqind), TV Pink (25 përqind), RTS1 (24 përqind) dhe RTK (10 përqind). Komuniteti goran më së shpeshti shikon RTS1 (26 përqind), TV Pink (16 përqind), RTK (16 përqind), KTV (11 përqind) dhe "kanale të tjera" (9 përqind) (të dhëna nga audienca mediatike studimi i matjes i kryer në nëntor 2019).

¹²⁴ Komuniteti romë më së shpeshti shikon RTK (25 përqind), pasuar nga KTV (17 përqind), RTV21 (16 përqind) dhe Rrokum TV (13 përqind). Komuniteti egjiptian shikon RTV21 (35 përqind), ndjekur nga Klan Kosova (20 përqind), RTK (20 përqind), KTV (11 përqind) dhe Alsat M (6 përqind). Komuniteti ashkali më së shpeshti shikon zgjedh RTV21 (29 përqind), RTK (14 përqind), KTV (16 përqind), Alsat M (7 përqind) dhe Klan Kosova (7 përqind) (Po aty.)

¹²⁵ Pothuajse një e treta e turqve shikojnë "kanale të tjera turke" (28 përqind) para se t'i kthehen RTK-së (17 përqind), ndjekur nga stacionet televizive nga Turqia Kanal D (12 përqind) dhe TRT (9 përqind) (Po aty.).

¹²⁶ Në vitin 2020 RTK ka raportuar se skema programore e saj është si vijon: Program 45 minutësh "Nedeljni Kolaž" në gjuhën serbe të hënën nga 15:15 deri 16:00; program 45 minutësh "Mozaik" në gjuhën turke të martën nga 15:15 deri në 16:00; program 45 minutësh nga gazetari serb Budimir Niçiq të mërkurën nga qendra e mediave në gjuhën serbe; program 45 minutësh "Yekiphe" në gjuhën rome të shtunën; programi "Mostovi" në gjuhën boshnjake të premtën; program për komunitetet ashkali dhe egjiptian të shtunën nga 16:45 - 17:15; program 15 minutësh në gjuhën gorane një herë në muaj. "Programet e komuniteteve" transmetohen në RTK1 dhe janë të disponueshme përmes satelitit. As skema programore dhe as përmbajtja e programit nuk janë në dispozicion në internet.

¹²⁷ Për shembull, ajri i kondicionuar dhe një printer i vogël raportohet se nuk mirëmbahen.

në mënyrë kritike burimet e lajmeve dhe interesat potencialisht të fshehur, dhe në këtë mënyrë të mbledhin informacione më të paanshme.

Pjesa tetë: Kthimi dhe të drejtat pronësore të personave të zhvendosur

Rekomandime nga Rezoluta e KiE:

"Zhvillimi i kornizës ligjore gjithëpërfshirëse për të kthyerit, standardizimi i proceseve dhe mekanizmave, përfshirë krijimin e bazës qendrore të të dhënave, prioritizimin e zgjidhjes së rasetve të kthimit të pronave, si dhe përmirësimin e koordinimit midis institucioneve në nivel qendror dhe lokal dhe mbështetjen e këtyre të fundit për të ndihmuar kthim të qëndrueshëm dhe të sigurt;

Konsultimi në mënyrë efektive me Këshillin Konsultativ për Komunitete (KKK) për të gjitha çështjet që kanë rëndësi për komunitetet pakicë dhe sigurimi që mekanizmat e mbrojtjes specifike për komunitetet të përmbushin në mënyrë efektive rolin e tyre si mundësi për të gjitha pakicat që të marrin pjesë në vendimmarrje; përmirësimi i rekrutimit të personave që i përkasin komuniteteve pakicë në administratën publike; bërja e përpjekjeve për të siguruar pranimin e të kthyerve nga komuniteti shumicë."

Statistikat

Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), që nga dhjetori 2019, 28,302 persona të zhvendosur janë kthyer në/brenda Kosovës që nga viti 2000.¹²⁸ Shumica e të kthyerve kanë qenë serbë.¹²⁹ Shkalla e kthimit është në rënie secilin vit, që përfaqëson trend në rënie që nga edicioni i katërt i Raportit të vlerësimit të të drejtave të komuniteteve.¹³⁰ UNHCR ka vlerësuar që 16,151 persona të zhvendosur gjenden brenda Kosovë, 412 nga të cilët jetojnë në 22 strehimore kolektive.¹³¹

Kuadri institucional

Zhvillimi më i dukshëm në kornizën ligjore që rregullon kthimet ishte miratimi i Rregullores nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme,¹³² e cila hyri në fuqi në janar të vitit 2018. Duke zëvendësuar kornizën e mëparshme të politikave, Rregullorja ka ndryshuar mekanizmin për përpunimin e

¹²⁸ Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-së, *Pasqyrim Statistikor*, dhjetor 2019.

¹²⁹ po aty.

¹³⁰ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Raporti i Vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, Edicioni i Katërt (supra shënim 6); Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-së në Kosovë. *Pasqyrim statistikor*. Dhjetor 2019

¹³¹ Po aty.

¹³² Rregullorja Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, 4 janar 2018.

kërkesave për kthim të personave të zhvendosur. Komisionet komunale për kthim (KKK) janë themeluar si organi kryesor rekomandues në nivel komunal. Që nga dhjetori i vitit 2019, 32 komuna kishin krijuar KKK.¹³³ Komisioni Qendror për Kthim mban rolin e tij si organ vendosës në përzgjedhjen e përfituesve. Janë emëruar koordinatorët rajonalë për të përmirësuar linjën e komunikimit midis Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), por roli i tyre ende duhet të konsolidohet. Këto ndryshime synojnë të rrisin mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e KKK-ve. Megjithatë përcaktohet me Rregullore, KKK nuk ka implementuar ende sistem të administrimit të rasteve për personat e zhvendosur dhe kthimet vullnetare.

Më 25 maj 2015, u krijua Grupi Punues Ndërministror për Kthim i udhëhequr nga MKK (Grupi Punues) për të zgjidhur çështjet e lidhura me kthimin për shqiptarët e zhvendosur në lagjen Kroi i Vitakut, Mitrovicë Veriore. Grupi Punues përbëhet nga ministri për komunitete dhe kthim, ministri i administrimit të pushtetit lokal, kryetarët e Mitrovicës Veriore dhe Mitrovicës Jugore, dy përfaqësues të të kthyerve shqiptarë, dy përfaqësues të banorëve serbë të lagjes Kroi i Vitakut, dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare.¹³⁴ Mirëpo, gjatë periudhës së raportimit Grupi Punues u takua vetëm një herë.

Bashkëpunimi rajonal

Avancim tjetër domethënës ishte zhvillimi i iniciativës rajonale për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova, duke arritur kështu një nga objektivat e identifikuara në Strategjinë e MKK-së 2014-2018 për Komunitete dhe Kthim. "Iniciativa ndërinstitucionale për personat e zhvendosur nga Kosova", e njohur si Procesi i Shkupit, u fillua në nëntor të vitit 2014. Përmes një *komunikate të përbashkët*, përfaqësuesit e nivelit të lartë nga Prishtina, Beogradi, Shkupi dhe Podgorica ranë dakord të punojnë në zgjidhje të qëndrueshme në nivel rajonal.¹³⁵ Delegacionet krijuan kornizë të përbashkët veprimi për pesë fusha tematike: të drejtat pronësore; siguria, dialogu dhe ri-integrimi; dokumentacioni personal; menaxhimi i të dhënave; planifikimi i zgjidhjeve.

Siguria e të kthyerve

Numër i madh i incidenteve të sigurisë vazhdojnë të ndodhin në vendet e kthimit.¹³⁶ Sipas monitorimit të OSBE-së, këto vepra penale mund të shkojnë nga vjedhje të vogla deri në zjarrvënie dhe sulme. Më të përhapurat janë vjedhjet e shtëpive të pabanuara të serbëve.¹³⁷ Ndonëse shumë nga këto vepra penale mund të kenë motiv kryesisht

¹³³ Komunat që nuk kanë KKK: Glogoc, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zvečan dhe Junik.

¹³⁴ Shih Ministria për Komunitete dhe Kthim, *Buletini Vjetor (janar-dhjetor 2015)*, në dispozicion në: http://mzprks.org/bilten/bilten_en.pdf (qasur më 15 maj 2020).

¹³⁵ *Komunikata e përbashkët* nga Konferenca e nivelit të lartë për zhvendosjen nga Kosova, 27-28 nëntor 2014, Shkup, në dispozicion në <https://www.osce.org/kosovo/129376> (qasur më 15 maj 2020).

¹³⁶ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Vlerësim i kthimeve vullnetare në Kosovë*, dhjetor 2019, në dispozicion në: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/440726>, (qasur më 15 maj 2020), fq 24-25.

¹³⁷ Po aty.

ekonomik dhe raportohen në Policinë e Kosovës (PK), një perceptim negativ i sigurisë është rritur në mesin e të kthyerve sepse shumë kryerës të veprave penale i kanë shpëtuar drejtësisë. Kjo, në kombinim me perceptimin e komuniteteve për krimet kundër të kthyerve, ka kontribuar në perceptim negativ të sigurisë për të kthyerit, duke e penguar kështu procesin e kthimit.¹³⁸ Në të vërtetë, monitorimi i OSBE-së ka zbuluar se incidentet e tilla i dekurajojnë të kthyerit e mundshëm. Në nivel komunal, kërcënimet e perceptuara të sigurisë nuk dënohen gjithmonë publikisht nga komunitatet. Kur rastet dënohen, mesazhi jo gjithnjë arrin tek komunitetet e prekura.

Të drejtat pronësore të personave të zhvendosur

Gjatë periudhës së raportimit, është arritur përparim i caktuar në lidhje me mbrojtjen e komuniteteve jo-shumicë dhe të drejtave pronësore të personave të zhvendosur. Më 18 Janar 2017, qeveria miratoi Strategjinë e Kosovës për të drejtat pronësore,¹³⁹ dokument ky kryesor i politikave mbi këtë çështje. Strategjia përmban një kapitull mbi të drejtat pronësore të personave të zhvendosur, duke përshkruar detyrimin e institucioneve për të respektuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ajo gjithashtu numëron problemet e mëdha shqetësuese që kanë të bëjnë me gëzimin e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe udhëzimet e politikave për t'i adresuar ato. Shembujt përfshijnë uzurpimin e paligjshëm, zbatimin e skemës së kompensimit të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore,¹⁴⁰ shpronësimin, legalizimin e ndërtimeve pa leje, ndërtimin nga palët e treta, shitblerjet e rrejshme të pronave, tatimin në pronë, ndarjen e tokës për projekte të lidhura me kthimin, vendbanimet joformale dhe banimet sociale.

Janë vërejtur zhvillime pozitive që burojnë drejtpërdrejt nga Strategjia në lidhje me adresimin e tatimit në pronën e paluajtshme të personave të zhvendosur. Ligji mbi tatimin në pronën e paluajtshme ishte shpallur në tetor të vitit 2018.¹⁴¹ Ky ligj përcaktonte se personat e zhvendosur janë të liruar nga të gjitha detyrimet e tatimit në pronë për periudhën kur prona e tyre ishte e uzurpuar.¹⁴² Për më tepër, më 23 korrik 2018, Kuvendi miratoi Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.¹⁴³ Ligji parasheh mbrojtje të të drejtave pronësore për personat e zhvendosur në pronat e të cilëve ka ndodhur ndërtimi i

¹³⁸ Po aty.

¹³⁹ Ministria e Drejtësisë, *Strategjia e Kosovës për të drejtat pronësore*, Tetor 2016, në dispozicion në: http://www.kryeminist-ks.net/repository/docs/SKDP_17_10_2016_ENG.pdf (qasur më 15 maj 2020).

¹⁴⁰ Kërkesat e kategorisë "A" kanë të bëjnë me shqiptarët e Kosovës, punësimi i të cilëve ishte ndërprerë nga legjislacioni diskriminues i miratuar nga ish-regjimi, ku ata i kishin humbur të drejtat e tyre mbi apartamentet në pronësi shoqërore. Zakonisht, apartamentet e tilla iu ishin ndarë më pas serbëve të cilët më pas ishin shpërngulur, kategoria "C". Sipas legjislacionit që rregullon Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB), parashtruesi i kërkesës "A" mund të rikthehet në apartament dhe paditësi "C" do të pranojë kompensim për të drejtat e humbura mbi apartamentin. AKKVP kohët e fundit vlerësoi se kostoja e skemës së kompensimit do të ishte 1.7 milion €. Sipas informacionit të siguruar nga menaxhmenti i AKKVP-së në maj të vitit 2019, Qeveria e Kosovës deri më tani ka ndarë 1.2 milion € për skemën.

¹⁴¹ Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin mbi pronën e paluajtshme, 15 qershor 2018.

¹⁴² Bazuar në një vendim përfundimtar të lëshuar nga një institucion publik në Kosovë që është kompetent për të shqyrtuar rastet e uzurpimit.

¹⁴³ Ligji Nr 06/L-024 për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, 2 dhjetor 2014.

paligjshëm. Sipas Ligjit, një palë që ka ndërtuar një ndërtesë nuk mund ta legalizojë atë përveç nëse i dëshmon të drejtat pronësore mbi tokën.¹⁴⁴

Mbeten një numër pengesash për qasjen e personave të zhvendosur në të drejtat pronësore dhe gëzimin paqësor të pronës. Megjithëse ka pasur përmirësime në njoftimin e palëve të prekura nga shpronësimi në Kosovë, njoftimi i personave të zhvendosur mbetet sfidë në vete. Për më tepër, problemet rreth sigurimit të qasjes adekuate në gjykata në mënyrë që palët e prekura të kundërshtojnë vendimet e shpronësimit ende vazhdojnë¹⁴⁵. Sipas informacionit në dispozicion të OSBE-së, zgjidhja e rasteve të pasurisë në gjykatat e Kosovës zgjat nga një deri në pesë vite duke vonuar kështu qasjen në kohë në të drejtat pronësore të paditësve të suksesshëm.¹⁴⁶ Për më tepër, Ligji i miratuar rishtazi për ndarjen për përdorim dhe shkëmbim të pasurive të paluajtshme të komunës nuk i përfshin të kthyerit si kategori specifike që mund të përfitojë nga ndarja e tokës komunale,¹⁴⁷ që paraqet sfidë për kthimin. Monitorimi i OSBE-së ka vërejtur se skemat e strehimit social shpesh favorizojnë grupe të caktuara të shoqërisë, siç janë veteranët e konfliktit, në dëm të atyre që janë më të prekurit në aspektin social, të cilët shpesh janë nga komuniteti romë.

Për më tepër, Agjencia Kosovare e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronave (AKKVP),¹⁴⁸ si mekanizëm i trajtimit të kërkesave në masë e krijuar për të zgjidhur kategori specifike të kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin, nuk po përmbush në mënyrë efektive aspektet e mëposhtme të mandatit të saj: dëbimin e uzurpatorëve nga pronat që i përkasin komuniteteve jo-shumicë dhe personave të zhvendosur, rrënimin e strukturave të paligjshme,¹⁴⁹ dhe zbatimin e 143 vendimeve të lëshuara për kompensim.¹⁵⁰ Çështjet e tilla paraqesin pengesa serioze për gëzimin e të drejtave pronësore nga palët e prekura.

Ndryshimet në Ligjin për AKKVP-në për të bërë të mundur dëbimet e shumëfishta në rastet e uzurpimit ende nuk janë miratuar, ashtu si ndryshimet për të zgjeruar skemën e administrimit të AKKVP-së për pronat që i përkasin komuniteteve jo-shumicë dhe personave të zhvendosur. Për më tepër, përgjegjësia që AKKVP trashëgoi nga Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore për të kompensuar financiarisht palët që humbën të drejtën e tyre pronësore për shkak të praktikave diskriminuese në vitet 1990 ende nuk është zbatuar dhe Agjencia nuk i ka rrënuar strukturat e paligjshme të ndërtuara në pronat e personave të zhvendosur. Institucionet përgjegjëse të Kosovës ende nuk i kanë trajtuar çështjet që lidhen me zbatimin e Ligjit për financimin e programeve specifike të

¹⁴⁴ Po aty. Neni 102

¹⁴⁵ Më 26 shkurt 2019, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e inicioi ndryshim/plotësimin e Ligjit për shpronësim për të adresuar këto shqetësime.

¹⁴⁶ Vlerësimi bazuar në rastet e zgjedhura pronësore të paraqitura në gjykata të Kosovës që përfshijnë komunitete jo-shumicë dhe persona të zhvendosur që shërbeu për "Përmbledhjen e gjykatave të Kosovës për çështjet pronësore" nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në vitin 2018.

¹⁴⁷ Ligji Nr. 06/L – 092 për Ndarjen për shfrytëzim dhe shkëmbim të pronave të paluajtshme të komunës, 4 Prill 2019.

¹⁴⁸ Agjencia Kosovare e Pronave pushoi së ekzistuari me themelimin e AKKVP-së si institucion i pavarur në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave, miratuar më 9 qershor 2016.

¹⁴⁹ Sipas informacionit të siguruar nga menaxhmenti i AKKVP-së në maj të vitit 2019, Qeveria e Kosovës ka ndarë 30,000 EUR për rrënimin dhe AKKVP ka angazhuar një kompani për këto rrënime. Mirëpo, asnjë nga 55 ndërtimet pa leje të ndërtuara në pronën e personave të zhvendosur nuk është rrënuar ende.

¹⁵⁰ AKKVP ka nxjerrë 93 vendime për kompensim, nga gjithsej 143 raste, që janë në pritje të zbatimit.

strehimit për të siguruar strehim adekuat për komunitetet dhe gratë e cënueshme,¹⁵¹ nuk e ka miratuar Strategjinë për Vendbanimet Joformale për të formalizuar këto vendbanime dhe titujt pronësor, dhe zgjidhur rastet e shitblerjeve të rrejshme të pronave. Gjykatat mbeten përgjithësisht joefikase kur trajtojnë çështjet e lidhura me pronën. Përfundimisht, AKKVP nuk është në gjendje të krahasojë dhe verifikojë titujt e pronave sepse Qeveria e Serbisë ende nuk i ka dorëzuar librat kadastralë në institucionet e Kosovës.¹⁵²

¹⁵¹ Ligji Nr. 03/L-164 për Financimin e programeve specifike të banimit, 25 shkurt 2010.

¹⁵² Marrëveshja e Brukselit ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për Librat kadastralë, 21 tetor 2011.

Pjesa nëntë: Arsimi

Rekomandime nga Rezoluta e KE:

"Të prioritizohen përpjekjet gjithëpërfshirëse dhe konkrete për të promovuar dialogun ndëretnik dhe tolerancën në nivel qendror dhe lokal, në mënyrë që të largohen pengesat ndarëse ndërmjet komuniteteve dhe të promovohet pajtimi, duke marrë parasysh që shumica shqiptare në Kosovë ka përgjegjësi të veçantë në këtë drejtim; të ndërtohen marrëdhënie ndërmjet komuniteteve përmes iniciativave që synojnë në veçanti të rinjtë, integrimin e sistemit arsimor dhe zbatimin e njëtrajtshëm të legjislacionit gjuhësor;

Të miratohen të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatim të plotë, të barabartë dhe adekuat të Ligjit për përdorimin e gjuhëve; të adresohen boshllëqet në kapacitetet e nivelit qendror dhe lokal rreth njohurisë së gjuhëve, cilësisë së përkthimit zyrtar dhe ofrimit të shërbimeve në gjuhët e pakicave, përfshirë në sistemin gjyqësor; të krijohet mjedis i favorshëm që mundëson mësimin e gjuhëve zyrtare dhe të pakicave.

Të prioritizohet zhvillimi i kurrikulës së integruar në gjuhën serbe, si mundësi adekuate për arsimim si gjuhë e parë për anëtarët e komuniteteve numerikisht më të vogla, si dhe mundësi për të mësuar gjuhë zyrtare dhe të tjera të pakicave; të zhvillohen materiale për mësimdhënie dhe nxënie cilësore në të gjitha gjuhët e pakicave pa stereotipe ose përfaqësime të tjera të dëmshme, si dhe module që mbështesin ruajtjen e identitetit, gjuhës dhe kulturës së komuniteteve në konsultim me përfaqësuesit e tyre; të përmirësohen programet e aftësimin të mësuesve për të akomoduar diversitetin në klasë dhe për të promovuar dialogun, respektin dhe mirëkuptimin ndërkulturor."

Arsimi në gjuhën serbe

Si në ciklet e mëparshme të raportimit, sigurimi i qëndrueshëm i arsimit në gjuhën serbe në Kosovë mbetet i pazgjidhur. Shkollat me sistem të Kosovës të drejtuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ofrojnë arsim në gjuhët shqipe, boshnjake dhe turke. Arsimi në gjuhën serbe në Kosovë sigurohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik e Serbisë (MESTD). Përafërsisht 130 shkolla në gjuhën serbe operojnë në 24 komuna të Kosovës.¹⁵³

Shumica e komunave deri diku i mbështesin shkollat me sistem të Serbisë, duke iu siguruar atyre dru zjarri, mirëmbajtje, pagesë të kostove të shërbimeve, transportim të nxënësve dhe pagë të personelit të shkollës.¹⁵⁴

¹⁵³ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Qasja e komuniteteve në arsimin parauniversitar në Kosovë*, dhjetor 2018, në dispozicion në: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/406952?download=true> (qasur më 8 prill 2020).

¹⁵⁴ Po aty.

Sigurimi i qëndrueshëm i arsimit në gjuhën serbe në Kosovë nuk ka qenë pjesë e Marrëveshjes së lehtësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Përjashtimi i vetëm është njohja e ndërsjellë e diplomës.¹⁵⁵

Marrëveshja e fundit (2016) teknike midis Prishtinës dhe Beogradit për njohjen e ndërsjellë të diplomave nuk është zbatuar asnjëherë.¹⁵⁶ Diplomat e lëshuara nga institucionet arsimore me sistem të Serbisë në Kosovë pas vitit 1999 përfshirë Universitetin e Mitrovicës së Veriut (UMV) nuk i nënshtrohen marrëveshjes së arritur.

Në vitin 2015, Qeveria e Kosovës nxori Rregulloren nr. 21/2015 për verifikimin e diplomave të lëshuara nga UMV pas vitit 2001 për qëllime të aplikimit për punë, për të marrë licenca profesionale dhe për t'iu nënshtuar provimeve në institucionet publike.¹⁵⁷ Rregullorja ka lehtësuar qasjen në punësim në Kosovë për shumë të diplomuar të UMV nga komunitete të ndryshme.¹⁵⁸ Qeveria ka ndërmarrë hapa për të zgjeruar mandatin e Rregullores për të përfshirë diplomat e të gjitha niveleve të lëshuara nga të gjitha institucionet e tjera arsimore që punojnë me sistem të Serbisë në Kosovë.

Pavarësisht nga dispozitat ligjore ekzistuese që u mundësojnë shkollave me sistem të Serbisë në Kosovë të përdorin librat e tyre të hartuara nga MESTD pas rishikimit dhe miratimit të MASH,¹⁵⁹ nuk ka pasur asnjë rast ku kurrikulat apo tekstet e shkollave nga ndonjëra prej këtyre shkollave janë sjellë në MASH për rishikim. Nga ana tjetër, MASH nuk ka hartuar kurrikulë të vet në gjuhën serbe edhe pse është gjuhë zyrtare në Kosovë me status të barabartë si gjuha shqipe. Prandaj nxënësit nga komunitete të ndryshme që dëshirojnë të ndjekin arsimin në gjuhën serbe, mund ta bëjnë këtë vetëm në shkollat me sistem të Serbisë.

Katërmbëdhjetë shkolla "të përziera" ku nën një çati mësohet me të dy sistemet atë të Kosovës dhe Serbisë, funksionojnë në nëntë komuna.¹⁶⁰ Të dy sistemet ose ndajnë të njëjtën ndërtesë, ose dy ndërtesa shkollore - ku secila funksionon me njërin sistem -

¹⁵⁵ Shih Zyra e Kryeministrit, *Konkluzione për njohjen e ndërsjellë të diplomave bazuar në marrëveshjet fillestare nga viti 2011*, 19 janar 2016

[http://www.kryeministri-](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Concactions_on_mutual_diploma_recognition_based_on_the_original_agreements_from_2011.pdf)

[ks.net/repository/docs/Concactions_on_mutual_diploma_recognition_based_on_the_original_agreements_from_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Concactions_on_mutual_diploma_recognition_based_on_the_original_agreements_from_2011.pdf); Zyra e Kryeministrit, *Konkluzion operacional i grupit të punës për Diplomat*, Bruksel, 21 Mars 2016

[https://kryeministri-ks.net/wp-](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Operational_conclusion_of_the_working_group_on_Diplomas_Brussels,21_March_2016.pdf)

[content/uploads/docs/Operational_conclusion_of_the_working_group_on_Diplomas_Brussels,21_March_2016.pdf](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Operational_conclusion_of_the_working_group_on_Diplomas_Brussels,21_March_2016.pdf).

¹⁵⁶ Shih raportin e progresit të Ministrisë për Dialog mbi zbatimin e marrëveshjeve (faqe 2), 7 korrik 2017

[https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/REPORT -](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/REPORT_-_Brussels_Agreements_Pending_Implementation_060717.pdf)

[Brussels_Agreements_Pending_Implementation_060717.pdf](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/REPORT_-_Brussels_Agreements_Pending_Implementation_060717.pdf).

¹⁵⁷ Rregullorja (QK) Nr. 21/2015, "Mbi procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Kosovës që kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, me qëllim të aplikimit për punë, marrjes së licencave profesionale dhe hyrjes në provimet profesionale të institucioneve publike." [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_\(QRK\)_-_NR_212015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_(QRK)_-_NR_212015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf).

¹⁵⁸ Që nga 15 korriku 2020, situata është si vijon: Komisioni i ka pranuar gjithsej 1,732 kërkesa; 1.678 kërkesa janë pranuar dhe certifikuar nga Komisioni; 41 kërkesa janë në pritje/shqyrtim nga komisioni; 40 vendime negative janë lëshuar nga komisioni; 10 kërkesa jo të plota të pranuar nga komisioni.

¹⁵⁹ Shih nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komuna, 21 maj 2008 dhe nenin 8.5, LMPDK (më lartë shënimi 52).

¹⁶⁰ Më lartë shënimi 153.

ndajnë kopshtin shkollor brenda një kompleksi. Edhe në ato shkolla, ndërveprimi midis nxënësve dhe personelit nga dy sistemet është përgjithësisht i kufizuar. Nismat për t'i bashkuar ato janë marrë vetëm nga aktorë jo-institucional si shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare. Nisma të tilla kufizohen vetëm në aktivitete të lira.

Mësimdhënia e gjuhëve zyrtare

Gjuha shqipe nuk mësohet në shkollat me sistem të Serbisë. Në mënyrë të ngjashme, serbishtja nuk u ofrohet nxënësve si lëndë e gjuhës zyrtare nga shkollat me sistem të Kosovës. Organizata të ndryshme ndërkombëtare kanë organizuar dhe financuar kurse mësimore jashtëshkollore të gjuhës shqipe dhe serbe për nxënës dhe mësimdhënës nga dy sistemet e ndara në disa shkolla dhe komuna.

Përmbajtja e materialeve mësimore

Në vitin 2017, një raport¹⁶¹ i botuar nga OJQ-ja "Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut" (YIHR) zbuloi se librat shkollorë të sistemit të Kosovës për nivelin e mesëm të lartë përmbajnë gjuhë diskriminuese për etninë, gjininë dhe grupet e marginalizuara. Sipas raportit, librat shkollorë të analizuar kanë përjetësuar stereotipe dhe kanë përdorur terma përçmues për të përshkruar komunitetet e ndryshme etnike dhe fetare, rolet gjinore (*p.sh.* se si rritja e punësimit të grave ka pasoja negative për familjen), sëmundjet mendore, etj.

Arsimi në gjuhët e komuniteteve

Arsimi në gjuhën boshnjake dhe turke si gjuhë të komunitetit në Kosovë ka qenë përgjithësisht në dispozicion.¹⁶² Mirëpo, disponueshmëria e librave shkollorë në të dy gjuhët mbetet problem. Përkthimi i teksteve shkollore në boshnjakisht dhe turqisht nuk ka përfunduar për të gjitha nivelet dhe shkallët e arsimit parauniversitar që nga fillimi i përdorimit të kornizës kurrikulare aktuale në vitin 2011.

Nxënësve të cilët arsimohen në njërin nga dy gjuhët u mungon një numër i teksteve shkollore, disa prej të cilave importohen nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Turqia, përkatësisht, dhe nuk janë përshtatur në kontekstit. Shqipja u sigurohet si lëndë e gjuhës zyrtare nxënësve që mësojnë në gjuhën boshnjake ose turke. MASH ende nuk i ka hartuar librat shkollorë për mësimin në gjuhën shqipe për nxënësit, gjuha e parë e të cilëve nuk është shqipja.

¹⁶¹ Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR KS), *Gjuhët diskriminuese në tekstet shkollore, Analizë e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë*, nëntor 2017, në dispozicion në: <https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2018/09/Discriminatory-language-in-school-textbooks.pdf> (qasur më 8 prill 2020).

¹⁶² Shih më lartë shënimin 153.

Me përjashtim të gjuhës, historisë, arteve dhe lëndëve të kulturës në gjuhët boshnjake dhe turke, asnjë lëndë tjetër specifike për komunitetin nuk është zhvilluar për nxënësit nga komunitetet numerikisht më të vogla për të mësuar rreth kulturave të tyre dhe për të ruajtur identitetin e tyre. Përfaqësuesit e komuniteteve nuk kanë bërë asnjë kërkesë në MASH për zhvillimin e lëndëve të tilla. Orë ekstrakurrikulare të gjuhës rome organizohen në Prizren. *(Për më shumë detaje ju lutemi shikoni pjesën për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë.)*

Programet e studimit të aftësisë të mësuesve në boshnjakisht dhe turqisht kanë vazhduar të përballen me vështirësi për sa i përket qëndrueshmërisë së tyre. Në vitin 2016, programet e vetme të llojit të tillë nuk u akredituan për shkak të mungesës së personelit të mjaftueshëm arsimor me gradën e doktoratës në - Universitetin e Prizrenit. Një masë e përkohshme u prezantua më pas nga MASH dhe Agjencia e Akreditimit e Kosovës për të mundësuar realizimin e programeve të studimit në gjuhët e komuniteteve, përfshirë ato të trajnimit të mësuesve, paralelisht me programet në gjuhën shqipe për kohëzgjatje prej pesë viteve.¹⁶³ Në vitin 2019, Universiteti i Prizrenit humbi akreditimin e tij si në nivel të programeve të studimit ashtu edhe si institucion. Ky zhvillim vuri në dyshim qëndrueshmërinë e përgjithshme të arsimit të lartë në gjuhët e komuniteteve në Kosovë. Qeverisë i kërkohet me ligj të sigurojë programe studimi të aftësisë të mësuesve në gjuhët e komunitetit.¹⁶⁴

¹⁶³ Shih nenin 26.5.3.10 të MASH UA nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë.

¹⁶⁴ Shih nenin 8.8, LMPDK (shënimi më lartë 52).

Pjesa dhjetë: Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian

Rekomandime nga Rezoluta e KiE:

"Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës 2017-2021 për të përmirësuar qasjen në arsim, përfshirë nga perspektiva e barazisë gjinore, përmes institucionalizimit të qendrave të mësimi dhe ndërmjetësve dhe gjetjen pa vonesë të mënyrave alternative për personat që i përkasin komunitetit egjiptian për të përfituar nga masa të ngjashme me ato të parapara në strategji; menjëherë të ndërpritet çdo formë e segregimit në shkollë; të promovohet qasje efektive për personat që u përkasin këtyre komuniteteve në punësim dhe shërbime sociale."

Strategjia dhe Plani i Veprimit

Pas skadimit të strategjisë së mëparshme të përfshirjes në vitin 2015, procesi i gjatë dhe i ndërlikuar i hartimit e vonoi miratimin e dokumentit të ri strategjik. Prosesi i hartimit u drejtua nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) brenda Zyrës së Kryeministrit me mbështetjen e një projekti të financuar nga BE "Rrjeti i Arsimit dhe Punësimi në Kosovë" (KEEN), i implementuar nga organizata joqeveritare "Qendra Kosovare e Edukimit". Vetë procesi ishte gjithëpërfshirës, me pjesëmarrje të gjerë të institucioneve qeveritare, organizatave të shoqërisë civile,¹⁶⁵ dhe akterëve ndërkombëtarë. Sidoqoftë, drafti i dokumentit kërkonte ripërpunim të gjerë para se të nxirrej një version i zbatueshëm. Diskutimet mbi përfshirjen e komunitetit egjiptian në fushëveprimin e Strategjisë së re e vonoi edhe më tej miratimin e saj. Më 8 prill 2017, Qeveria e Kosovës më në fund miratoi aprovoi dhe miratoi "Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë Kosovare 2017 - 2021" (Strategjia).¹⁶⁶

Vlen të theksohet që, me kërkesë të udhëheqësit politik të komunitetit, komuniteti egjiptian nuk u përfshi në Strategjinë 2017-2021. Që nga dhjetori i vitit 2019, Qeveria e Kosovës nuk kishte përgatitur dokument të veçantë strategjik për komunitetin.

Strategjia është dokument gjithëpërfshirës që si cak i ka katër sektorë kryesorë: arsimin, punësimin dhe mirëqenien sociale, shëndetësinë dhe banimin. Janë identifikuar tre çështje tjera të përbashkëta: barazia gjinore, siguria dhe regjistrimi civil. Objektivat

¹⁶⁵ Me përfshirjen e disa OJQ-ve aktive në fushën e përfshirjes së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian u krijua një "Platformë" joformale. Ato luajtën rol integral në procesin e hartimit: "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians"; "Balkan Sunflowers"; Agjencia Kosovare për Avokim dhe Zhvillim; "Roma and Ashkali Documentation Centre"; "The Ideas Partnership"; "European Centre for Minority Issues Kosovo"; "Health for All". Një lëshim i dukshëm ishte mospërfshirja e Rrjetit të Organizatave të Grave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian (RROGRAEK), përfshirja e të cilit do të përmirësonte dimensionin gjinor të Strategjisë.

¹⁶⁶ Zyra për Qeverisje të Mirë, *Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Shoqërinë e Kosovës 2017 - 2021*, në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_P%C3%8BR_P%C3%8BRFSHIRIEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_N%C3%8B_SHOO%C3%8BRIN_%C3%8B_KOSOVARE_2017-2021.pdf (accessed on 15 May 2020).

strategjikë përcaktohen për secilin sektor kyç, me një listë të rezultateve të pritura, aktiviteteve të parashikuara për realizimin e rezultateve, dhe treguesve, synimeve dhe nivelit bazë të zbatueshme. Të gjitha aktivitetet janë numëruar në një plan veprimi të detajuar me plan shumëvjeçarë për hapat, kostot e pritshme, burimet e pritshme të financimit dhe institucionet përgjegjëse për bashkërendim. Për tre vitet e para të zbatimit të saj (2017–2019), Strategjia parasheh buxhet të përgjithshëm prej 8,684,758 EUR. Bursat e studentëve dhe pagesat e mirëqenies sociale përfaqësojnë pjesën më të madhe të buxhetit të alokuar. Burimet e donatorëve janë paraparë për gati dy të tretat (64.4 përqind) të buxhetit të paraparë, ndërsa buxhetet komunale priten të mbulojnë 2.3 përqind të totalit.

Plani i detajuar i veprimit të Strategjisë lejon rishikim relativisht të thjeshtë vjetor të zbatimit. Shqyrtimi i fundit në dispozicion, që përfshin vitin 2018, u botua në vitin 2019.¹⁶⁷ Kjo tregon se, në vitin 2018, institucionet përgjegjëse shpenzuan 5,049,311 EUR për zbatimin e Strategjisë. Pagesat e ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përbënin gati tre të katërtat e shpenzimeve totale (73.4 përqind).¹⁶⁸ Mirëpo, të dhënat për realizimin e shumë treguesve për vitin 2018 nuk ishin në dispozicion.¹⁶⁹

Mekanizmat institucional komunal

Strategjia parasheh krijimin e organeve të niveleve komunale, të quajtura "komitete të veprimit komunal" (KVK), për ta lehtësuar zbatimin e objektivave të strategjisë. Më 4 tetor 2017, ZQM, përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, u komunikoi një kërkesë kryetarëve të komunave për krijimin e KVK-ve. Komunitetet kanë qenë mbështetëse për krijimin e KVK-ve dhe, që nga dhjetori 2019, 15 komuna kishin krijuar KVK,¹⁷⁰ shpesh me mbështetjen e ZQM, KEEN, Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE) dhe OSBE-së. Që nga dhjetori i vitit 2019, 14 komuna¹⁷¹ kishin miratuar Planet Lokale të Veprimit (PLV) për përfshirjen e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës.¹⁷² PLV-të ofrojnë plane të përshtatura, të lokalizuara për të stimuluar përfshirje më të madhe të pjesëtarëve të tre komuniteteve.

¹⁶⁷ Zyra për Qeverisje të Mirë, *Raporti i dytë për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës 2017 - 2021*, 2019, në dispozicion në <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ENG%20-%20Final%20Raporti%20p%20C3%ABr%202018%20p%20C3%ABr%20zbatimin%20e%20Strategjis%20dhe%20Planit%20t%20C3%AB%20ve....pdf>, (qasur më 15 maj 2020).

¹⁶⁸ Shuma e shpenzuar ishte 3,706,932.50 EUR.

¹⁶⁹ Zyra për Qeverisje të Mirë, *Raporti për zbatimin e politikave publike për integrimin e romëve në Kosovë për vitin 2018, 2019*, në dispozicion në: <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Monitoring%20Report%20on%20Policy%20Implementation%20for%20Roma%20%20Ashkali%20and%20Egyptian%20Communities%20in%20Kosovo.pdf> (qasur më 15 maj 2020).

¹⁷⁰ Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Prishtinë, Shtime, Ferizaj, Prizren, Rahovec, Suharekë, Gjakovë, Istog, Klinë, Mitrovica e Jugut, Skenderaj, Vushtrri.

¹⁷¹ Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan, Obiliq, Prishtinë, Shtime, Ferizaj, Gjakovë, Istog, Klinë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Vushtrri.

¹⁷² Derisa komuniteti egjiptian nuk është e përfshirë në Strategjinë e qeverisë, ai në përgjithësi përfshihet në fushëveprimin e PLV-ve.

Për më tepër, tetë komuna me popullsi të madhe të pjesëtareve të tre komuniteteve¹⁷³ aktualisht janë përfshirë në projektin e përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian ROMACTED.¹⁷⁴ Projekti mbështet pjesëmarrjen e drejtuar nga komuniteti në proceset e vendimmarrjes në nivel komunal dhe krijon dy organe, një grup veprimi të komunitetit dhe një grup pune institucional.

Kuadri i fortë institucional që përfshin KVK-të, PVL-të, dhe organet e ROMACTED ka qenë i dobishëm në një numër nismash komunale nga të cilat përfitonin të tre komunitetet, shumica e të cilave janë përmirësime të infrastrukturës.¹⁷⁵ Sa i përket projekteve jo-infrastrukturore, komuna e Ferizajt ka ndërmarrë qasje proaktive për adresimin e braktisjes së shkollës.

Çështjet e arsimit

Në vitin shkollor 2018/2019, 261 ashkali, 161 romë dhe 160 egjiptianë u regjistruan në arsimin e mesëm të lartë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në partneritet me VoRAE, Fondin e Edukimit Rom, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur, ofroi 600 bursa në vit për nxënësit e shkollave të mesme nga të tre komunitetet. Mbi 50 studentë nga të tre komunitetet janë regjistruar edhe në universitetet publike.

Ka pasur vonesa të konsiderueshme në miratimin e udhëzimeve për zbatimin e Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 19/2018 për Qendrat e Mësimit. Një numër i madh i qendrave të mësimit hasën vështirësi financiare ose pushuan së funksionuari tërësisht. Kjo mund të ketë ndikim të konsiderueshëm negativ pasi qendrat e mësimit luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen arsimore dhe parandalimin e braktisjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Orët e gjuhës, kulturës dhe historisë romë janë ofruar në shkollat në Prizren që nga viti 2011. Gjatë periudhës raportuese, MASHT-i u përpoq të zgjerojë orët në Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Obiliq dhe Pejë. Mirëpo, pas problemeve me zgjedhjen e shkollave dhe mungesën e fondeve, orët e mësimit ose nuk filluan kurrë ose vetëm u zhvilluan vetëm për periudhë të kufizuar.¹⁷⁶ Që nga dhjetori i vitit 2019, orët e mësimit u ofruan vetëm në shkollat me sistem të Kosovës në Prizren dhe në disa shkolla me sistem të Serbisë në Gjilan, Kamenicë dhe Mitrovicë Veriore.¹⁷⁷

¹⁷³ Gjakova, Graçanica, Mitrovica e Jugut, Lipjani, Fushë Kosova, Ferizaji, Istogu dhe Obiliqi.

¹⁷⁴ Më shumë informacion mund të merrni në: <https://rm.coe.int/romacted-at-a-glance-kosovo-january-2020/16809991a9>.

¹⁷⁵ Shembuj përfshijnë ndërtimin e sistemeve të kanalizimeve në fshatin Sërbobran në Istog, lagjen Ali Ibra në Gjakovë dhe lagjen Kristali në Pejë, instalimin e dritave të rrugëve në fshatin Medvec në Lipjan dhe shtrimin e rrugës në lagjen 2 Korriku në Mitrovicën e Jugut.

¹⁷⁶ Shih më lartë shënimin 153 f. 16.

¹⁷⁷ Monitorimi afatgjatë i ekipeve në terren të OSBE-së.

Përfaqësimi publik

Pjesëtarët e tre komuniteteve përfaqësohen në vendimmarrje. Pas zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës në tetor 2019, një rom, një ashkali dhe dy egjiptianë u bënë deputetë të Kuvendit.¹⁷⁸ Që nga dhjetori i vitit 2019, tre komuna kishin nënkryetarë të komunës për komunitete nga radhët e komunitetit ashkali.¹⁷⁹ Përfaqësimi i tre komuniteteve në shërbimin civil mbetet gjithashtu sfidë në vete. Për më tepër, pak anëtarë të tre komuniteteve janë zyrtarë të PK-së. Nga gjithsej 7.959 zyrtarë policorë, 0.23 përqind janë ashkali, 0.19 përqind janë romë dhe 0.10 përqind janë egjiptianë.¹⁸⁰ Vetëm një gjyqtar në sistemin e drejtësisë në Kosovë është nga njëra prej këtyre tre komuniteteve (romë).

¹⁷⁸ Albert Kinolli për komunitetin rom, Etem Arifi për komunitetin ashkali, Veton Berisha dhe Elbert Krasniqi për komunitetin egjiptian.

¹⁷⁹ Ferizaj: Florim Bajrami; Fushë Kosovë: Qerim Gara; Lipjan: Lulzim Qerimi.

¹⁸⁰ Tetëmbëdhjetë policë ashkali; 15 policë romë dhe tetë policë egjiptianë.

Pjesa njëmbëdhjetë: Integrimi socio-ekonomik

Rekomandime nga Rezoluta e KiE:

"Të prioritizohen programet dhe aktivitetet që si çak e kanë punësimin për të promovuar integrimin ekonomik të grave dhe burrave nga komunitetet jo-shqiptare, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian."

Statistikat e punësimit

Papunësia në Kosovë ka mbetur një nga sfidat kryesore përgjatë viteve. Në vitin 2018, shkalla e papunësisë ishte 29.6 përqind, ndërsa papunësia afatgjatë dhe papunësia e të rinjve ishte më e lartë, përkatësisht 58.4 përqind dhe 55.4 përqind.¹⁸¹ Shkalla e lartë e papunësisë prekë të gjitha nivelet e popullatës; sidoqoftë, ajo prekë në mënyrë disproporcionale komunitetet jo-shumicë dhe përkeqëson edhe më tej situatën e tyre shpesh të vështirë sociale-ekonomike, veçanërisht atë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.

Sipas të dhënave të UNDP, Komisionit Evropian dhe Bankës Botërore 2017,¹⁸² 49 përqind e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të moshës mes 15 dhe 64 vjeç ishin të papunë, përballë 32 përqind të pjesëtarëve të komuniteteve tjera në atë kohë. Mirëpo, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2019 vlerësoi se niveli i papunësisë ishte mbi 90 përqind tek pjesëtarët e komuniteteve romë dhe ashkali dhe pohon se anëtarët e këtyre komuniteteve zakonisht punojnë në sektorin joformal, duke mbajtur punë të pasigurt, me aftësi të ulët dhe me status të ulët,¹⁸³ siç janë ndërtimi sezonal ose puna bujqësore, prerja e druve dhe mbledhja e metaleve skrap dhe materialeve të riciklueshme.¹⁸⁴ Sigurimi i një pune në sektorin privat mbetet sfidë, ndërsa vetëm disa janë të angazhuar në sektorin publik. Është interesante që shkalla e papunësisë në radhët e grave nga të tre komunitetet është praktikisht e barabartë me shkallën e papunësisë tek gratë nga komunitetet tjera.¹⁸⁵ Mirëpo, burrat nga të tre komunitetet kanë gati dy herë më shumë gjasa të jenë të papunë sesa burrat nga komunitetet tjera.¹⁸⁶ Për më tepër, 78 përqind e të rinjve të moshës 18-24 vjeç nga tre komunitetet (88 përqind e grave të reja dhe 70 përqind e burrave të rinj) klasifikohen se nuk janë të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim, krahasuar me 47 përqind të pjesëtarëve të komuniteteve tjera.

¹⁸¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Kosovës 2019, në dispozicion në: https://ask.rks-gov.net/media/5082/vjetari-2019_ang-final.pdf (qasur më 15 maj 2020).

¹⁸² UNDP, Komisioni Evropian dhe Banka Botërore, *Roma at a Glance*, prill 2018, në dispozicion në: https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/factsheets/Factsheet_KOSOVO_V05_print.pdf (qasur më 15 maj 2020).

¹⁸³ Shih më lartë shënimin 112.

¹⁸⁴ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Pasqym i komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë*, janar 2020, në dispozicion në: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/443587> (qasur më 15 maj 2020).

¹⁸⁵ 53 përqind dhe 52 përqind respektivisht.

¹⁸⁶ 48 përqind dhe 27 përqind respektivisht.

Në vitin 2018, 95.890 persona nga të gjitha komunitetet janë regjistruar si të papunë, me shqiptarët që përbëjnë pjesën më të madhe (83.6 përqind), ndjekur nga serbët (7.7 përqind); ndërsa romët (1.8 përqind), ashkallitë (2.8 përqind) dhe egjiptianët (0.9 përqind) të cilët përfaqësojnë një pjesë të vogël të numrit të përgjithshëm të të papunëve të regjistruar.¹⁸⁷ Mirëpo nëse i vendosim në perspektivë, këto shifra tregojnë se 20 përqind e popullsisë së përgjithshme të komunitetit rom, 17 përqind e komunitetit ashkali dhe 7 përqind e popullsisë së përgjithshme të komunitetit egjiptian (bazuar në regjistrimin e popullatës të vitit 2011) ishin regjistruar të papunë; Për dallim, 5 përqind e popullsisë së përgjithshme shqiptare ishin regjistruar si të papunë. Kur merren parasysh vetëm individët në moshën e punës (15– 64), shifrat rriten në 34 përqind për romët, 30 përqind për ashkallitë dhe 12 përqind për egjiptianët, ndërsa shifra për shqiptarët e Kosovës është 8 përqind. Për komunitetin boshnjak, shifrat janë 6 dhe 9 përqind, përkatësisht, dhe për komunitetin turk turk 3 dhe 4 përqind.¹⁸⁸ Bazuar në të dhënat e siguruar nga byrotë e punësimit nga 16 komuna,¹⁸⁹ në përgjithësi 3,191 romë, ashkali dhe egjiptian janë regjistruar si punëkërkues aktiv deri në fund të vitit 2018; ku ndarja etnike në dispozicion ishte si vijon – 1,409 ashkali; 1,269 romë; dhe 248 egjiptian.¹⁹⁰

Mungesa e informacionit për zyrat e punësimit dhe qendrat e formimit profesional, shoqëruar me fushata joefektive për informimin e publikut, rrezikojnë qasjen e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në tregun e punës.¹⁹¹ Megjithëse Masat Aktive të Tregut të Punës (ALMM) synojnë të nxisin punësimin, pjesëmarrja e tre komuniteteve në ALMM ka mbetur shumë e ulët në vitin 2018, me vetëm 99 përfitues gjithsej. Nga 3,764 ndërmjetësime të rregullta të punësimit të kryera, në 91.1 përqind të rasteve pjesëtarët e komunitetit shqiptar ishin përfitues, ndërsa pjesëtarët e secilit komunitet jo-shumicë përbënin më pak se dy përqind të numrit të përgjithshëm të përfituesve.¹⁹² Në përgjithësi, 5.497 persona kanë vijuar trajnime profesionale, ku shqiptarët përbënin 95.8 përqind të tyre, ndërsa pjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë ishte jashtëzakonisht e ulët.¹⁹³

Mirëqenia sociale

Me shkallën e lartë të papunësisë, shumë familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian varen nga ndihma sociale e siguruar nga MPMS. Në Mars të vitit 2019, 205 familje të komunitetit romë,¹⁹⁴ 833 familje të komunitetit ashkali,¹⁹⁵ dhe 430 familje të

¹⁸⁷ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës, Puna dhe punësimi në Kosovë, *Raporti vjetor 2018*, f. 19.

¹⁸⁸ Një analizë e ngjashme nuk ka mundur të bëhet për komunitetet tjera pasi që regjistrimi i vitit 2011 nuk i ka përfshirë malazezët dhe kroatët si komunitete të ndara, ndërsa Raporti Vjetor i MPMS nuk përmend goranët. Për më tepër, regjistrimi i vitit 2011 nuk ka të dhëna të besueshme për komunitetin serb.

¹⁸⁹ Deçani; Ferizaj; Fushë Kosova; Graçanica; Istogu; Kamenica; Klina; Mamusha; Novobërda; Mitrovica; Obiliqi; Podujeva; Shtimja; Rahoveci; Prizreni; Vushtrria.

¹⁹⁰ Shih më lartë shënimin 184.

¹⁹¹ *Implementimi i Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës në vitin 2017*, Raporti i vlerësimit, në dispozicion në: https://www.keen-ks.net/site/assets/files/1405/raporti_i_monitorimit_per_komunitete_eng.pdf, (qasur më 15 maj 2020), f. 46.

¹⁹² Shih më lartë shënimin 187 – f. 34.

¹⁹³ Po aty, fq 41.

¹⁹⁴ Që përbëjnë 2,000 individë, ose mesatarisht 9.76 anëtarë të familjes.

¹⁹⁵ Që përbëjnë 3,581 individë, ose mesatarisht 4.30 anëtarë të familjes.

komunitetit egjiptian¹⁹⁶ po pranonin ndihmë sociale. Pagesat e ndihmës sociale në Kosovë variojnë nga 60 EUR në muaj për një familje të vetme në 180 EUR në muaj për një familje me 15 persona.¹⁹⁷ Andaj, familjet më të mëdha pranojnë më pak ndihmë financiare për anëtarë, gjë që ka ndikim negativ në familjet e komunitetit romë në veçanti. Në vitin 2019, MPMS filloi një reformë të legjislacionit të ndihmës sociale,¹⁹⁸ i cili pasi të miratohet do t'i bëjë pagesat e ndihmës sociale më të drejta.

Programet e punësimit

Organizatrat joqeveritare, filluan disa nisma të suksesshme për avancimin e gjendjes socio-ekonomike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë në veçanti. OJQ "The Ideas Partnership" themeloi një ndërmarrje sociale "Sa-pune" për të mbështetur familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë në gjenerimin e të ardhurave. Në total, 18 gra (pesë të komunitetit ashkali, katër të komunitetit rom dhe nëntë të atij egjiptian) u trajnuan dhe më pas u punësuan në tre qendra operative¹⁹⁹, për të prodhuar sapunë organikë, çanta livandoje dhe kartolina filigrani, si dhe qepje të produkteve dhe çantave miqësore ndaj mjedisit.²⁰⁰ Njëpërmjet punës së OJQ-së "VoRAE" 194 vende pune janë ndërmjetësuar me institucione publike dhe private, 234 individë të rinj kanë përfunduar trajnimin profesional, dhe 73 familje kanë përfituar nga mikro-kreditë dhe sistemi i granteve të vogla, të cilat ua kanë mundësuar atyre të zhvillojnë bizneset e tyre të vogla.²⁰¹ Disa OJQ kanë krijuar edhe programe të punës praktike duke ua mundësuar kështu të rinjve nga komunitetet jo-shumicë të marrin përvojë profesionale. OJQ VoRAE organizon programe të punës praktikë për të rinjtë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në kuadër të projektit të tij "Equally Engage II"²⁰² ndërsa OJQ-ja "Qendra për Paqe dhe Tolerancë" ka angazhuar praktikantë nga komunitetet serbë dhe romë në programin e saj të organizuar në komunat me shumicë serbe. OJQ-ja "Roma Versitas" është duke lansuar program për vendosjen e studentëve dhe të diplomuarve të universiteteve nga radhët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në institucionet qeveritare. Përveç programeve të punës praktike të lehtësuara nga organizatat e shoqërisë civile, Zyra për Çështje të Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit ka organizuar tradicionalisht program të punës praktike për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë.

¹⁹⁶ Që përbënë 947 individë, ose mesatarisht 2.20 anëtarë të familjes.

¹⁹⁷ Shifrat në dispozicion në, *Studimin e Skemës së Ndihmës Sociale të Kosovës*, 2019 të Bankës Botërore, në dispozicion në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf> (qasur më 15 maj 2020), f. 23. Metodologjia për llogaritjen e shumës së përfitimit është paraqitur në mënyrë të detajuar në Udhëzimin Administrativ të MPMS-së nr. 15/2012 Për llogaritjen e shumave mujore të ndihmës sociale, në dispozicion në: <https://mpms.rks-gov.net/en/wpdm-package/udhezimi-administrativ-nr-15-2012-pdf/> (qasur më 15 maj 2020).

¹⁹⁸ Komunikata për shtyp në dispozicion në: <https://mpms.rks-gov.net/en/ministri-recica-lanson-ne-konsultime-publike-koncept-dokumentin-per-skemen-e-ndihmes-sociale/> (qasur më 15 Maj 2020).

¹⁹⁹ Fushë Kosovë, Janjevë (Lipjan) dhe Sërbobran (Istog).

²⁰⁰ Organizata Ndërkombëtare e Punës, duke promovuar mundësi të mira pune për të rinjtë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, në dispozicion në: https://www.ilo.org/budapest/what-we-do/publications/WCMS_619034/lang-en/index.htm (qasur më 15 maj 2020), f. 78.

²⁰¹ OJQ "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians", *Programi i Punësimit*, në dispozicion në: <https://vora.org/programs/3> (qasur më 7 prill 2020).

²⁰² Kohët e fundit e ka lansuar një program të punës praktike për të rinjtë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë. Procesi i përzgjedhjes është duke vazhduar dhe si rezultat do të zgjidhen 52 individë.

Në nivel komunal, disa komuna²⁰³ ku pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë banojnë në numër të konsiderueshëm kanë miratuar PLV-të. Disa PLV përmbajnë aktivitete që synojnë të rrisin praninë e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në tregun e punës dhe të përmirësojnë kushtet e tyre socio-ekonomike. Aktivitetet variojnë nga fushatat informuese dhe panairët e punës deri tek ndarja e subvencioneve për pronarët e bizneseve.²⁰⁴ Përkundër hapave proaktivë, numri i iniciativave është i ulët dhe kryesisht i kufizuar në aktivitete informuese, të cilat nuk sigurojnë zbutjen e papunësisë. Disa aktivitete të parapara në PLV kryhen nga organizata të shoqërisë civile ose partnerë zhvillimor, ²⁰⁵ gjë që tregon varësinë nga mbështetja e donatorëve. Duhet të merren më shumë masa konkrete për zbatimin e PLV-ve; megjithatë, mungesa e vullnetit politik dhe burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore²⁰⁶ janë rrethana frenuese për disa komuna.

Veprimet pozitive dhe programet që si cak e kanë trajtimin e papunësisë së komunitetet jo-shumicë janë penguar nga mosekzistimi i të dhënave të ndara në baza etnike në statistikat e nivelit të qeverisë. Në mungesë të masave të shënjestruara, mungesa e kualifikimit dhe aftësive mbetet e pazgjidhur, e cila shoqëruar me faktorë të tjerë, pengon qasjen në mundësitë e punësimit dhe zmadhon përjashtimin socio-ekonomik, veçanërisht për anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.

²⁰³ Shih më lartë shënimin 171.

²⁰⁴ Rrjeti i Arsimit dhe Punësimit i Kosovës, *Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës - Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushe Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan*, në dispozicion në: http://keen-ks.net/site/assets/files/1475/raporti_i_monitorimit_per_komunitetet_eng.pdf, (qasur më 31 mars 2020), ff. 30, 42, 85.

²⁰⁵ Po aty faqe 30.

²⁰⁶ Po aty, faqe 30, 72 dhe 85.

Konkluzion

Brenda periudhës së raportimit (janar 2016 - dhjetor 2019), institucionet e Kosovës kanë arritur njëfarë progresi në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë dhe pjesëtarëve të tyre në përputhje me detyrimet e KKKP-së. Megjithë përparimin në disa fusha, vazhdojnë të vlejnjë rekomandimet e Rezolutës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Kosovën nga korriku 2019. Veçanërisht duke i ditur ngjarjet politike ende fluide, institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë përparim të vazhdueshëm dhe të rrisin fokusin në avancimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë, si gur themel në ndërtimin e një shoqërie vërtet përfshirëse, paqësore dhe të qëndrueshme.

Zhvillime të rëndësishme pozitive në periudhën katër vjeçare të raportimit përfshijnë integrimin e gjyqësorit, miratimin e një rregulloreje ligjërish të detyrueshme për kthimin e personave të zhvendosur dhe miratimin e disa dokumenteve kryesore të politikave në fushën e trashëgimisë kulturore. Efektiviteti i Institucionit të Avokatit të Popullit gjithashtu është përmirësuar, dhe qeveria ka krijuar kornizë gjithëpërfshirëse institucionale për të lehtësuar përfshirjen e plotë të komuniteteve rom dhe ashkali dhe pjesëtarëve të tyre në shoqëri.

Megjithatë, në fusha të tjera situata nuk ka ndryshuar dukshëm që nga botimi i edicionit të mëparshëm të RVDK në dhjetor 2015. Ende ka probleme në lidhje me zbatimin e plotë të legjislacionit për përdorimin e gjuhëve. Arsimi në gjuhën serbe mbetet i padisponueshëm brenda kornizës institucionale të Kosovës, dhe qasja në arsimin e lartë në gjuhët boshnjake dhe turke mbetet sfidë. Mekanizmat institucionalë të mandatuar me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve mbeten të pashfrytëzuar, megjithë përmirësimet e vogla në performancën e tyre. Më pak persona të zhvendosur kthehen në Kosovë çdo vit përkundër përparimeve institucionale. Përmbajtja e mediave të prodhuara në vend për komunitetet jo-shumicë vazhdon të jetë e pakët. Shkalla e papunësisë në mesin e shumicës së pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë, veçanërisht romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, mbetet joproporcionalisht e lartë, megjithëse disa komunitete, si ai turk, tregojnë nivele shumë të ulëta të papunësisë. Ajo që duhet cekur është që incidente të sigurisë që prekin anëtarët e komuniteteve jo-shumicë vazhdojnë të ndodhin dhe tensionet ndëretnike vazhdojnë. Përpjekjet për të krijuar mekanizmat e së vërtetës dhe pajtimit nuk kanë arritur ende rezultate të prekshme. Koordinimi i planifikimit strategjik në fushën e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë mbetet sfidë, dhe komunitetet si ai kroat dhe malazez të Kosovës ende nuk kanë vende të garantuara në Kuvend.

**Raport për
vlerësimin
e të drejtave të
komuniteteve**
Botimi i pestë